



USHTRIA



Viti i 75-të i botimit Nr. 39 (827791)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 30 Shtator 2022

Gjeneral brigade Arben Kingji mori pjesë në Konferencën e 25-të të Shefave të Shtabit të vendeve të Kartës së Adriatikut

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneral brigade Arben Kingji, mori pjesë në Konferencën e 25-të të Shefave të Shtabit të vendeve të Kartës së Adriatikut (A-5, US - Adriatic Charter), e cila u zhvillua më 21-23 shtator, në Budva, Mal i Zi. Konferenca u drejtua nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Malit të Zi, gjeneral brigade Zoran Lazarevic, si dhe

me pjesëmarrjen e komandantit të Komandës Amerikane në Europë (US EUCOM), gjeneral Christopher Cavoli, kryetari i Komitetit Ushtarak të NATO-s admiral Rob Bauer, si dhe drejtuesit e Gardave Kombëtare të SHBA-ve. Fillimin e punimeve të konferencës e përshëndeti presidenti malazez z. Milo Gjukanoviq. Tema e këtij takimi ishte "Sfidat e sigurisë në rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe zhvillimi i kapac-

iteteve të përbashkëta të FA- e të vendeve të A-5 për t'iu përgjigjur këtyre sfidave". Shefat e shtabeve shkëmbyen mendime mbi situatën aktuale të sigurisë dhe sfidat që përballet rajoni, duke riafirmuar angazhimin dhe përpjekjet e përbashkëta për një rajon të qëndrueshëm dhe të sigurt. U diskutuan gjithashtu bashkëpunimi i deritanishëm dhe ai i ardhshëm për vendet e A-5... >>> faqe 2



Nënskruhet kontrata për shërbimin satelitor, Peleshi: Hymë në një epokë të re Kryeministri Rama: Do të kemi një kryeinspektorat në qiell, i cili nuk ka emër të përveçëm, por ka një sy që i sheh të gjitha



57 - vjetori i krijimit të Batalionit të Mbështetjes

Batalioni i Mbështetjes së Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura ka festuar 57 - vjetorin e krijimit të tij. Me këtë rast, në mjediset e këtij reparti u zhvillua një ceremoni ku ishin të pranishëm: ministri i Mbrojtjes, z. Niko Peleshi, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së gjeneral brigade Arben Kingji, gjeneralë dhe komandantë të njëjstëve dhe reparteve, ish-drejtuës dhe komandantë që kanë shërbyer ndër vite në këtë batalion. Komandanti i batalionit, kolonel Ardian Lulaj, në fjalën e tij të hapjes...



>>> Faqe 2

Kremtohet 65 - vjetori i krijimit të Shërbimit Hidrografik Shqiptar

Në Komandën e Forcës Detare u zhvillua ceremonia me rastin e 65 - vjetorit të krijimit të Shërbimit Hidrografik Shqiptar. Pjesëmarrës në këtë ceremoni ishte zëvendës shefi i shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneralmajor Manushaqe Shehu, ish-drejtuese e Shërbimit Hidrografik ndër vite, personel të shtabit dhe reparteve të Forcës Detare si dhe të ftuar të tjerë. Ceremonia u hap nga Komandanti i Forcës Detare, i cili ndër të tjera u shpreh se: "Shërbimi Hidrografik Shqiptar vjen..."



>>> Faqe 4

Spitali Ushtarak, institucioni me histori të lavdishme 93 - vjeçare

Intervistë me Prof. Asoc. Dr. Sybi Musollari
Spitali Ushtarak mbetet referenca Se vetme e mjekësisë ushtarake në Forcat e Armatosura (FA). Në memorien e brezave të ushtarakëve, ky institucion është i një rëndësie të veçantë. Ai është dhe mbetet një nga institucionet mjekësore më të rëndësishme në Shqipëri për traditën, eksperiencën e krijuar në vite. Dhe pse emërtimet e tij kanë ndryshuar në dekada, ai në kujtesën e njerëzve mbetet me emrin e njohur popullor, Spitali Ushtarak. Për shumë vite, ai në pjesën dërrmuese u shërbente vetëm ushtarakëve por duke parë profesionalizmin...



>>> Faqe 6

Gjeneral brigade Arben Kingji mori pjesë në Konferencën e 25-të të Shefave të Shtabit të vendeve të Kartës së Adriatikut

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneral brigade Arben Kingji, mori pjesë në Konferencën e 25-të të Shefave të Shtabit të vendeve të Kartës së Adriatikut (A-5, US - Adriatic Charter), e cila u zhvillua më 21-23 shtator, në Budva, Mal i Zi.

Konferenca u drejtua nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Malit të Zi, gjeneral brigade Zoran Lazarevic, si dhe me pjesëmarrjen e komandantit të Komandës Amerikane në Europë (US EUCOM), gjeneral Christopher Cavoli, kryetari i Komitetit Ushtarak të NATO-s admiral Rob Bauer, si dhe drejtuesit e Gardave Kombëtare të SHBA-ve. Fillimin e punimeve të konferencës e përshëndeti presidenti malazez z. Milo Gjukanović.

Tema e këtij takimi ishte "Sfidat e sigurisë në rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe zhvillimi i kapaciteteve të përbashkëta të FA- e të vendeve të A-5 për t'iu përgjigjur këtyre sfidave".

Shefat e shtabeve shkëmbyen mendime mbi situatën aktuale të sigurisë dhe sfidat që përballet rajoni, duke riafirmuar angazhimin dhe përpjekjet e përbashkëta për një rajon të qëndrueshëm dhe të sigurt. U diskutuan gjithashtu bashkëpunimi

Gjeneral brigade Arben Kingji: Do vazhdojmë të mbështesim politikën e "dyerve të hapura" për të gjithë rajonin, për të forcuar më tej marrëdhëniet dhe bashkëpunimin midis vendeve të A-5



i deritanishëm dhe ai i ardhshëm për vendet e A-5, me theks të veçantë në disa fusha, kryesisht kontributin në forcimin e sigurisë rajonale, si dhe iniciimin e projekteve të përbashkëta.

Gjatë fjalës së tij gjeneral brigade Kingji, theksoi se: "Rajoni i Ball-

kanit vijon të përballet me një sërë kërcënimesh dhe sfidash, si politike, ekonomike, ushtarake apo edhe me sulmet e rënda kibernetike të ndodhura së fundmi. Të gjitha këto janë një kërcënim potencial për rajonin tonë. Pranimi i anëtarëve të rinj në

A-5, posaçërisht i Kosovës, është një vendim i duhur dhe ne të gjithë duhet të vazhdojmë të mbështesim "Politikën e dyerve të hapura" për të gjithë rajonin, për të forcuar më tej marrëdhëniet dhe bashkëpunimin midis vendeve të A-5".

Njëherazi, gjeneral brigade Kingji theksoi mbështetjen e fuqishme të SHBA-së për A-5, duke shprehur falënderim për angazhimin e vazhdueshëm në ruajtjen e stabilitetit rajonal dhe perspektivës euroatlantike të vendeve të Ballkanit Perëndimor.

Gjeneral brigade Kingji zhvilloi takim me gjeneral Cavolin, ku u diskutua për situatën e sigurisë në rajon, projektet e modernizimit të FA-së, trajnimet dhe stërvitjet, infrastruktura ushtarake më veçanërisht mbi Bazën detare në Pashaliman dhe Porto Palermo, transformimi i edukimit ushtarak në FA, si dhe

vlerësimi dhe mbështetja e SHBA-ve për Forcat e Armatosura shqiptare nëpërmjet financimi dhe trajnimeve të përbashkëta.

Ndërkohë takime të tjera u zhvilluan edhe me komandanten e Gardës Kombëtare të New Jersey-it, gjeneral brigade Lisa Hou, si dhe Komandantin e FSK-së, gjeneralletjnant Bashkim Jashari. Konferenca e 25-të e A-5 përfundoi me firmosjen e Deklaratës së Përbashkët. Shtetet anëtare riafirmuan përkushtimin e tyre ndaj parimeve të kësaj marrëveshjeje, mbështetur në Konceptin e Rivalizimit të kësaj Karte. Vendet anëtare të nismës A-5 janë Shqipëria, Bosnjë-Hercegovina, Kroacia, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe SHBA-të, ndërsa vende vëzhguese Kosova, Sllovenia dhe Serbia. Marrëveshja për formimin e nismës SHBA-Karta e Adriatikut u nënshkrua në vitin 2003, me qëllim që të promovonte dhe fuqizonte bashkëpunimin rajonal dhe sigurinë.

57-vjetori i krijimit të Batalionit të Mbështetjes

Batalioni i Mbështetjes së Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura ka festuar 57 - vjetorin e krijimit të tij. Me këtë rast, në mjediset e këtij reparti u zhvillua një ceremoni ku ishin të pranishëm: ministri i Mbrojtjes, z. Niko Peleshi, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së gjeneral brigade Arben Kingji, gjeneralë dhe komandantë të njësisve dhe reparteve, ish-drejtues dhe komandantë që kanë shërbyer ndër vite në këtë batalion.

Komandanti i batalionit, kolonel Ardian Lulaj, në fjalën e tij të hapjes, pasi falënderoi të pranishmit për pjesëmarrjen, solli një historik të shkurtër të këtij reparti ushtarak, që nga krijimi deri në ditët e sotme. Batalioni i Mbështetjes së Shtabit të Përgjithshëm është një ndër repartet elitë të Forcave të Armatosura dhe përmban në vetvete kontributin e vyer të shumë e shumë brezave të oficerëve/nënoficerëve, ushtarëve e punonjësve civil ndër vite.

Ky repart i ka fillimet e tij në vitin 1955 në nivel kompanie dhe data 24 shtator 1965 shënoi krijimin e Batalionit të Sigurimit të Shtabit të Përgjithshëm. Në vitin 2003 u quajt "Batalioni i Mbështetjes së Shtabit të Përgjithshëm", emërtim të cilin e mban dhe sot. Kjo strukturë, edhe pse ka emrin batalion, jo vetëm realizon ruajtjen dhe sigurinë e MM/SHPPFA dhe strukturave të



tjera që ndodhen në "Garnizonin Skënderbej", por kryen mbështetjen me shërbime, me transport dhe mbështetjen shëndetësore, gjithashtu krijon kushte për akomodim nëpërmjet shtëpive të pushimit të ushtarakëve.

Në fjalën e tij përshëndetëse ministri i Mbrojtjes, z. Niko Peleshi, drejtuar efektivit të këtij reparti, theksoi se 57 - vjetori i krijimit të Batalionit të Mbështetjes së Shtabit të Përgjithshëm është një ditë e rëndësishme për të gjithë ne, ndërsa ka vlerësuar punën dhe arritjet e shënuara prej tyre ndër vite. "Prapa çdo aktiviteti, operacioni, misioni, është puna juaj, e ushtarakëve dhe civilëve, pasi ju jeni pjesë e imazhit të FA-ve, madje pjesë e imazhit të Republikës së Shqipërisë, përmes strukturave si Orkestra Frymore dhe Truproja e Nderit", - tha ndër

të tjera Ministri Peleshi.

Në fund të fjalës së tij ministri i Mbrojtjes, ka siguruar edhe njëherë mbështetjen e tij për këtë repart shumë të rëndësishëm të Forcave tona të Armatosura.

Pas përfundimit të fjalëve përshëndetëse në mjediset e batalionit u luajt një pjesë muzikore nga struktura më e re "Orkestra Simfonike", që është bërë pjesë e batalionit së fundmi, e cila do të performojë për publikun e gjerë së shpejti dhe do të afrojë më shumë të rinjtë drejt familjes së madhe të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

Batalioni i Mbështetjes do të vazhdojë të demonstrojë shembullin më të mirë në dy shtyllat kryesore të vlerave, atë të qytetarit të klasit të parë dhe profesionistit dinjitoz në përmbushjen e detyrave dhe misionit.

Atasheu ushtarak kanadez, kapiten i rangut I Andre Boisjoli, vizitë në Komandën Mbështetëse

Në mjediset e Komandës Mbështetëse, atasheu ushtarak kanadez, kapiten i rangut I Andre Boisjoli, kreu një vizitë kortezie në këtë komandë. Kapiteni i rangut I Boisjoli u prit nga shefi i Shtabit të Komandës Mbështetëse, kolonel Arben Dhuli, i cili i uroi mirëseardhjen në Komandën Mbështetëse. Më pas takimi vijoi me një brifing informues, ku u njoh me misionin, detyrat, strukturën organizative, sfidat aktuale si dhe kontributet e Komandës Mbështetëse brenda dhe jashtë vendit. Fillimisht atasheu kanadez shprehur falënderimin për kontributet e strukturave të KM-së në kuadër të operacionit eFP në Letoni.

Një interes i veçantë u shfaq në operacionet e KM-së në kuadër të Emergjencave Civile dhe ato EOD në mbështetje të komunitetit në nevojë. Nga pala kanadeze u ofrua bashkëpunim e mbështetje e mëtejshme për Emergjencat Civile si dhe trajnime e kualifikime në të ardhmen për ushtarakët e kësaj komande. Kolonel Dhuli falënderoi atasheun kanadez për mbështetjen dhe ndihmën e Kanadasë për këtë komandë. Vizita u përmbyll me një dhuratë simbolike dhe frymën pozitive e besimin se ky bashkëpunim i mëtejshëm do të zgjasë midis dy palëve.



Nënshkruhet kontrata për shërbimin satelitor

Kryeministri Rama: Do të kemi një kryeinspektorat në qiell, i cili nuk ka emër të përveçëm, por ka një sy që i sheh të gjitha

Peleshi: Hymë në një epokë të re

Nënshkruhet kontrata e shërbimit satelitor në fushën e Mbrojtjes dhe Sigurisë për monitorimin me teknologji të avancuar të territorit të Republikës së Shqipërisë ndërmjet Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile dhe Operatorit "Satellogic USA Inc." me vlerë 6 milion dollarë.

Në prezantimin e këtij shërbimi të ri, që do të marrin institucionet shqiptare, ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi tha se, kjo kontratë përfaqëson një kapërcim teknologjik për Shqipërinë dhe për institucionet tona.

"Kjo kontratë ka vlerën 6 milionë dollarë. Kjo kontratë konsiston në përdorimin ekskluziv të 2 satelitëve, për një periudhë 3 - vjeçare, për monitorimin e territorit të Republikës së Shqipërisë, zhvillimin e kapaciteteve teknike e profesionale të Republikës së Shqipërisë për përdorimin e shërbimit satelitor, përpunimin e Informacionit Gjeohapësinor si dhe ofrimin e produkteve të imazherisë dhe komponentëve të tjerë të saj. Shqipëria do të ketë akses prioritar në dy nga satelitët që pritet t'i bashkohen flotës së "Satellogic" në lëshimin e saj të ardhshëm satelitor me "SpaceX", i cili do të quhet "Albania-1" dhe "Albania-2", - sqaroi ministri Peleshi.

Ministri shpjegoi me detaje shërbimet që do të marrin institucionet shtetërore shqiptare. "Së pari Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile do të marrë informacion mbi rrëshqitjet e tokës, lëvizjen e strukturave të rëndësishme të veçantë si: diga, ura, nivelin e ujit në liqene, basene, lumenj, numrin e godinave të shembura, sipërfaqen e zonave të përmytura, sipërfaqen e zonave të djegura, densitetin e popullsisë, rrugët e bllokuara, sipërfaqet e mbuluara nga bora, trashësia e borës. Do të marrë informacion mbi peshkimin detar, kontrollin e ujërave, ku në raste që konstatohen shkelje të kërkesave ligjore do të marrë masa administrative nga Sektori i Inspektimit dhe Kontrolli i Peshkimit. Do të monitorohet rrjeti i kanaleve ujëtare, kulluese, kanalet e ujërave specifike në situata me reshje intensive, në mënyrë që të analizohet sipërfaqja e prekur në tokat bujqësore apo në zonat e banuara", - u shpreh ministri i Mbrojtjes. Sipas tij, në fushën e turizmit do të shërbejë edhe duke dhënë informacion për cilësinë e ujërave bregdetare me synim promovimin e zonës bregdetare, si dhe erozionin bregdetar në funksion të mbrojtjes së zonës bregdetare dhe inventarizimin e saj.

Ai shtoi se, shërbimi satelitor do të ketë përdorim të gjerë në fushën ushtarake. "Këtë vit, ne përdorëm dronët "Puma" për kontrollin e zjarreve dhe pamë një ndryshim shumë të madh, por sa i përket menaxhimit të situatave të tilla, kursim dhe efikasitet të burimeve financiare për shkak se deri dje na duhej helikopteri për të bërë fotografime e sipërfaqeve me zjarre, që kushtonte, dhe me dronët "Puma" ishte minimal", - theksoi ministri.

"Një bazë të dhënash është një pasuri e madhe sepse duke instaluar aty inteligjencën artificiale dalin informacione që mund të na ndihmojnë në vendimmarrjen në të ardhme. Nuk e fillojmë nga zero, duhet thënë se



është bërë një punë shumë e madhe në kuadrin institucional, ligjor", - u shpreh ministri.

Kryeministri Rama, i pranishëm në nënshkrimin e kontratës deklaroi se: "Me lëshimin e këtyre satelitëve, ne hyjmë në një epokë tjetër në funksion të zbatimit të ligjit, në funksion të luftës kundër korrupsionit, në funksion të forcimit të shtetit dhe në funksion të barazisë përpara ligjit, por edhe në funksion të së drejtës së barabartë për të përfituar nga gjithë mbështetja shtetërore. Për të gjitha ata që na kanë përqeshur, janë skërmitur për satelitët, sot lajmi është që ne do të kemi një kryeinspektorat në qiell, i cili nuk ka emër të përveçëm, i cili nuk ka kushërinj, i cili nuk ka parti dhe i cili ka një sy që i sheh të gjitha dhe një detaj, që ministri, në gjithë renditjen e gjatë të gjërave që do të

bëjë ky kryeinspektorat, nuk e solli në vëmendje është që me satelitët nuk do të ketë më mundësi të ndërtohen kate pa leje pa u vënë re në momentin kur sapo nisin, sepse satelitët kanë kapacitetin të shohin çdo volum të ngritur mbi sipërfaqen e tokës me një saktësi që mbledhet në një perimetër prej 70 centimetrash", - deklaroi kryeministri Edi Rama.

Me anë të këtij shërbimi edhe Policia e Shtetit do të ketë të mundur marrjen e informacionit për kultivimin e bimëve narkotike, shfrytëzimin apo prerjen e paligjshme të pyjeve, gjuetinë e paligjshme, shkatërrimin e shtratit të lumenjve, shfrytëzimet e paligjshme të burimeve natyrore në zonat e mbrojtura, kalimin e paligjshëm në pikat kufitare, informacione të cilat do të mundësojnë evidentimin në kohë të akteve kriminale.



Zhvillohet ceremonia e dhënies së gradave në Akademinë e Forcave të Armatosura.

Akademia e Forcave të Armatosura organizoi ceremoninë e gradimit për personelin e saj.

Në këtë ceremoni morën pjesë Komandanti i AFA-së gjeneral brigade Albert Mullai, drejtues të institucioneve dhe personel i AFA-së.

"Marrja e gradës së radhës është shpërblim i kontributit të dhënë në vijimësi për punën tuaj, profesionalizmi, përkushtimi dhe përfaqësimi juaj dinjitoz, shpresoj të shërbejë si motivim dhe për kolegët tuaj që synojnë të përparojnë në karrierën ushtarake në të ardhmen. Sukses!", - u shpreh Gjeneral Mullai



Në zbatim të programit ekstrakurikular, studentët e vitit të parë të ciklit Bachelor zhvilluan vizita mësimore dhe kulturore në disa njësi e Reparte të FA-së, në Muzeun Historik Kombëtar dhe Etnografik të vendit tonë.



Forca **DETARE**



Forca Detare dhe Shërbimi Hidrografik kanë si synim rritjen e mëtejshme të sigurisë në hapësirën detare shqiptare, si një kontributor i rëndësishëm në ekonominë e vendit dhe veçanërisht në ekonominë blu.



Kremtohet 65 - vjetori i krijimit të Shërbimit Hidrografik Shqiptar

Në Komandën e Forcës Detare u zhvillua ceremonia me rastin e 65 - vjetorit të krijimit të Shërbimit Hidrografik Shqiptar. Pjesëmarrës në këtë ceremoni ishte zëvendëshefi i shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneralmajor Manushaqe Shehu, ish-drejtuese e Shërbimit Hidrografik ndër vite, personel të shtabit dhe reparteve të Forcës Detare si dhe të ftuar të tjerë.

Ceremonia u hap nga Komandanti i Forcës Detare, i cili ndër të tjera u shpreh se: “Shërbimi Hidrografik Shqiptar vjen në këtë 65-vjetor me përmbushjen e dy objektivave madhore në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar. Në maj të këtij viti Shqipëria u pranua si anëtare me të drejta të plota në Organizatën Ndërkombëtare të Hidrografisë (IHO) e miratuar dhe nga Kuvendi i Shqipërisë, Konventën për aderimin e Shqipërisë në Organizatën Ndërkombëtare të Ndihmave në Lundrimin Detar.

Të dyja këto arritje i japin një hov cilësor punës së Shërbimit Hidrografik për të arritur standardet e kërkuara ndërkombëtare si në fushën e prodhimit të hartave detare ashtu edhe sinjalistikës detare në tërësi. Forca Detare dhe Shërbimi Hidrografik kanë si synim rritjen e mëtejshme të sigurisë në hapësirën detare shqiptare, si një kontributor i rëndësishëm në ekonominë e vendit dhe veçanërisht në ekonominë blu. Mbatja në gatishmëri dhe përmirësimi teknologjik i sistemit të faro-fenerëve, prodhimi dhe azhurnimi i vazhdueshëm i hartave elektronike detare dhe bërja e tyre të aksesueshme për komunitetin e lundëtarëve në mbarë botën do të jenë prioritetet tona në vazhdim. Anëtarësimi i Shqipërisë në Organizatat Ndërkombëtare të IHO dhe IALA e vendosin Shqipërinë në hartën e vendeve të sigurta për sa i përket sigurisë në lundrim”. Ceremonia vijoi me fjalën përshëndetëse të zëvendëshefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneralmajor Manushaqe Shehu, e cila ndër të tjera u shpreh se: “Sot jemi krenarë dhe njëkohësisht u jemi mirënjohës të gjithë atyre ish-komandantëve apo punonjësve që krijuan dhe vazhduan punën për të siguruar këtë Shërbim Hidrografik që kemi sot, i cili i shërben sigurisë së jetës dhe sigurisë hidro - lundimore për të gjithë ata që lundrojnë në detin Adriatik dhe detin Jon. Më tej siguroi mbështetjen e strukturave eprorë në interes të zhvillimit të këtij reparti kaq të rëndësishëm për komunitetin dhe me interes kombëtar për sa i përket infrastrukturës detare. Ceremonia u mbyll me shfaqjen e një materiali me foto dhe video të veprimtarisë së këtij reparti në vite.



Atashetë ushtarakë, vizitë në Forcën Detare

Në Komandën e Forcës Detare zhvilluan një vizitë atashetë ushtarakë rezidentë të vendeve të NATO-s. Komandanti i Forcës Detare, kundëradmiral Adnan Agastra, iu uroi mirëseardhjen dhe shprehu konsideratat e tij për bashkëpunimin e frytshëm me Forcat e Armatosura në përgjithësi si dhe Forcën Detare në veçanti. Gjatë takimit u realizua dhe një prezantim nga shefi i Shtabit të Forcës Detare, kapiten i rangut I Sabri Gjinollari, mbi misionin, detyrat dhe aktivitetet operacionale që kryen Forca Detare. Në përfundim të takimit, grupi i atashëve zhvilloi një vizitë njohëse në bordin e anijes P-131, në Portin e Durrësit.



Përkujtohet 64 - vjetori i krijimit të Brigadës së Nëndetëseve dhe figura e komandantit të parë të kësaj brigade, Xhemal Shani

Në Komandën e Forcës Detare u zhvillua një ceremoni e veçantë me qëllim: evidentimin e historisë së ndritur të Brigadës së Nëndetëseve, krenaria e Flotës sonë Luftarake (FD), si dhe vlerave e kontributit të brezave të detarëve që kanë shërbyer në ND, që nga Komandanti I i saj, Kapiten i Rangut I, Xhemal Shani. Në këtë aktivitet të rëndësishëm morën pjesë veteranë, kuadro dhe marinarë të Brigadës së Nëndetëseve, familjarë të tyre, kuadro të FD-së.

Fillimisht në shenjë nderimi e respekti u bë një apel për ata kuadro dhe marinarë që kanë shërbyer në BrND dhe kanë ndërruar jetë. Ky apel u bë nga Kapiten i Rangut I (R), ish-komandant nëndetëseje, Vladimir Bajramaj, i ndjekur nga dy marinarë me uniformë.

Më pas përshëndeti komandanti i Forcës Detare, kundëradmiral Adnan Agastra, i cili e ka filluar karrierën si lundruar në nëndetëse. Ai nënvizoi rolin dhe rëndësinë që ka pasur Brigada e Nëndetëseve si dhe vlerat e shumanshme që kanë pasur kuadrot, specialistët dhe marinarët e kësaj njësie. Në emër të shoqatës



“Detaria shqiptare”, inxhinieri mekanik Bujar Bardhi përmendi disa momente nga historia e BrND. Ndërkohë ish-komandanti i ND dhe komandanti i Flotës, Tasim Mece, foli mbi momentet e para të jetës në Nëndetëse, vështirësitë dhe hapat e para të krijimit të Brigadës së ND. Me theks të veçantë komandant Tasimi evidentoi vlerat e gjithanshme të komandant Xhemal Shanit, rolin e tij në themelimin e Brigadës së ND, aftësitë e tij si drejtues e burrështetas.

Ish-komandant nëndetëseje, Jak Gjergji, foli mbi disa veçori të karakterit dhe personalitetit të komandant Xhemal Shanit, virtytet



prim që u prit me duartrokjetje nga të pranishmit. Kjo ishte një shenjë miratimi për këtë kuadër me vlera të gjithanshme si lundruar. Gjithashtu iu dha “Certifikatë mirënjohjeje” dhe aktorit të mirënjohur



e cilësitë që e bënë atë komandant të suksesshëm. Ish-nënoficer në nëndetëse, Fahri Perona, trajtoi disa momente si e ka njohur ai komandant Xhemal Shanin, gjatë kryerjes së detyrave.

Ceremoninë e përshëndetën gjithashtu dhe marinarë që kanë shërbyer në nëndetëse, të cilët sollën kujtime dhe mbresa nga jeta e një marinarit të ri në nëndetëse, marrëdhëniet me shokët, me eprorët. Kështu marinarin Perikli Cuni nga Fieri solli plot çaste nga jeta e një marinarit në nëndetëse, të realizuara dhe artistikisht.

Momenti i veçantë në këtë ceremoni ishte dhënia e “Certifikatave të Mirënjohjes”, komandant Xhemal Shanit, (mbas vdekjes), si komandant i Parë i BrND, ve-



Bujar Lakos (mbas vdekjes), për jetësimin e komandant Xhemalit dhe veprës së tij në filmin “Ballë për ballë”. (Mujo Bermema).

Me “Certifikatave të Mirënjohjes”, (mbas vdekjes), u vlerësuan dhe dëshmorët e BrND, detarët Jani Samara, Ismail Mehmeti, Aleksandër Prifti, Ruhi Hallkaj, të cilët ranë në krye të detyrës në nëndetëse.

Ceremonia u mbyll me një koktej të sponsorizuar nga familja Shani.

Zëvendëskomandanti i Forcës Tokësore pret në takim atasheun kanadez

Zëvendëskomandanti i Forcës Tokësore, gjeneral brigade Ferdinand Dimo, priti në takim atasheun ushtarak të Kanadasë, kapiten i rangut I Andre Boisjoli. Në takimin e zhvilluar në Komandën e Forcës Tokësore, nga të dyja palët u vlerësua niveli shumë i mirë i marrëdhënieve që ekziston mes vendeve dhe ushtrive tona mike dhe aleate në NATO.

Gjeneral Dimo, shprehu falënderimet për ndihmën dhe asistencën e dhënë nga Kanadaja në drejtim të arsimimit, trajnimit dhe mbështetjes për kontingjentet tona që shërbejnë në misionin eFP, Lituani, si dhe e njohu me zhvillimet kryesore të Forcës Tokësore gjatë viteve të fundit, në drejtim të certifikimit të Grup Batalionit të Këmbësorisë së Lehtë (GBKL) me statusin NATO "Mission Ready", ristrukturimit dhe kompletimit të reparteve operacionale, rritjes së shkallës së operacionalitetit nga repartet operacionale të deklaruara në NATO/VJTF, NRF/NRI, progresin e bërë në drejtim të modernizimit me armatim, sistemeve dhe pajisje të standardeve të NATO-s si dhe përmirësimit të infrastrukturës akomoduese dhe mbështetëse në strukturat e FT-së.



Zëvendëskomandanti i Forcës Tokësore, theksoi se eksperiencia e fituar nga bashkëpunimi me ushtrinë kanadeze ka ndihmuar në rritjen e ndërvprueshmërisë të efektivëve tanë, gjatë zhvillimit të stërvitjeve dhe misioneve të përbashkëta, duke përfutur dhe shpërndarë në repartet tona eksperiencën më të mirë të trupave ushtarake kanadeze.

Nga ana e tij, atasheu kanadez, kapiten i rangut I Boisjoli, falënderoi gjeneral

Dimon për mikpritjen e ngrohtë, duke e garantuar se FA-të e Kanadasë do të jenë gjithmonë në krah të miqve dhe aleatëve të tyre shqiptarë.

Ndër të tjera ai përgëzoi gjeneral Dimon dhe nëpërmjet tij të gjithë efektivët e Grup Batalionit të Këmbësorisë së Lehtë, për certifikimin "Mission Ready", duke shprehur besimin se bashkëpunimi midis dy ushtrive tona në të ardhmen do të vijojë të thellohet edhe më tepër.

Forca TOKËSORE



U zhvillua në Forcën Tokësore, ceremonia e dhënies së gradave për personelin e kësaj strukture për vitin 2022.



Batalioni III i Këmbësorisë mirëpret vizitën e studentëve të Akademisë së Forcave të Armatosura



Batalioni i Tretë i Këmbësorisë i Forcës Tokësore (b3kFT) mirëpriti vizitën e studentëve të vitit të dytë të nivelit Bachelor, të Akademisë së Forcave të Armatosura (AFA). Grupi i studentëve, së bashku me personelin komandues që i shoqëronte, u pritën fillimisht në ambientet e Shtabit dhe të Komandës së b3k, nga komandanti i këtij reparti, kolonel Gëzim Marku. Në prezantimin e përgatitur për ta, kolonel Marku i njohu

kadetët me misionin, detyrat dhe angazhimet e këtij reparti, jo vetëm në misionet paqeruajtëse, por edhe në ato në kuadër të Emergjencave Civile.

Me tej, takimi u zhvillua në formën e një bisede të lirë, me pyetje dhe përgjigje nga pjesëmarrësit. Në vijim të vizitës së tyre, studentët u njohën dhe panë nga afër edhe ambientet e punës dhe të stërvitjes së efektivëve të b3k. Ata u larguan nga reparti me përshtypjet më të mira.



Komanda dhe Shtabi i Batalionit të Parë të Këmbësorisë, zhvilloi këto ditë një mbledhje mësimore 3-ditore me personelin e oficerëve të rinj të emëruar së fundmi në këtë repart.



Nën drejtimin e instruktorëve të saj më të mirë, prej disa ditësh, Forca Tokësore ka filluar Stërvitjen Individuale Bazë (SIB). Synimi i këtij kursi është transformimi i rekrutëve të rinj nga civilë, në qytetarë të denjë nën uniformë, për t'i shërbyer atdheut në çdo kohë dhe në çdo vend.

Ekipi përfaqësues i Regjimentit të Operacioneve Speciale (ROS), u stërvit me ekipin e FSK në Kosovë, përpara dislokimit në Mbretërinë e Bashkuar, ku do të marrin pjesë në aktivitetin ndërkombëtar "Cambrian Patrol 2022". Ky është një aktivitet i cili zhvillohet nga Forcat Tokësore britanike, shtabi i Brigadës së 160 të Wellsit me pjesëmarrje të mbi 160 skuadrave, nga mbi 30 shtete. Kjo, është pjesëmarrja e katërt e ushtarakëve tanë në këtë kompeticion, pas pjesëmarrjes në vitet 2013, 2017, 2018.



Hapet Kursi i 74-të Fillestar dhe Kursi i 52-të Bazë i Nënoficerit në QAPN

Në ambientet e Qendrës së Arsimit Profesional të Nënoficerëve u hapën kurset e radhës, në zbatim të planit të arsimit të këtij viti, konkretisht Kursi i 74-të Fillestar dhe i 52-të Bazë. Kursi Fillestar i përbërë nga 45 kursantë, ku 6 prej tyre personel femër, i cili do të ndiqet nga kursantët për një periudhë 5-javore dhe ka si qëllim hedhjen e bazave për karrierën e nënoficerit, ofrimin e njohurive teoriko - praktike për drejtimin e grupit dhe niveleve të njësuarave me të, si dhe shpëputjen nga përgjegjësia individuale në aftësi e përgjegjësi si drejtues. Në këtë kurs marrin pjesë ushtarakët me gradën "ushtar/detar IV".

Kursi Bazë i Nënoficerit, i përbërë nga 35 kursantë, ku 6 prej tyre personel femër, ka si qëllim përgatitjen e drejtuesve në rol të komandantit të skuadrës në specialitetin përkatës dhe zgjat 8 javë.



INTERVISTË ME PROF. ASOC. DR. SYBI MUSOLLARI

Spitali Ushtarak, institucioni me histori të lavdishme 93-vjeçare

INTERVISTOI:
Shefe e Sektorit të Botimeve,
ANJEZA MUSOLLARI

Spitali Ushtarak mbetet referenca e vetme e mjekësisë ushtarake në Forcat e Armatosura (FA). Në memorien e brezave të ushtarakëve, ky institucion është i një rëndësie të veçantë. Ai është dhe mbetet një nga institucionet mjekësore më të rëndësishme në Shqipëri për traditën, eksperiencën e krijuar në vite. Dhe pse emërtimet e tij kanë ndryshuar në dekada, ai në kujtesën e njerëzve mbetet me emrin e njohur popullor, Spitali Ushtarak.

Për shumë vite, ai në pjesën dërrmuese u shërbente vetëm ushtarakëve por duke parë profesionalizmin dhe cilësinë e shërbimit, aty filluan të vizitohen personalitete nga të gjitha fushat e jetës. Ndoshta mbetet spitali me histori të lavdishme në historikun e spitaleve shqiptare. Pozicioni i tij, hapësira, skajshmëria, rëndësia në vite e bëjnë atë një legjendë me vete. Por ajo që e ka ngritur lart madhësitë e tij, është se për nga rëndësia, cilësia e shërbimit, profesionalizmi i mjekëve dhe infermierëve, ka bërë që në vite të mbahet si spitali më me autoritet. Këtë vit, në shtator, Spitali Ushtarak mbushi plot 93-vjet nga krijimi i tij. Një Spital me shumë histori, shumë ngjarje, shumë zhvillime. Në atë spital janë shëruar mijëra njerëz të të gjitha profesioneve.

Por për të na dhënë një panoramë më të detajuar të zhvillimit në vite të Spitalit Ushtarak, mbi aktivitetin, drejtuesit dhe arritjet në fushën mjekësore, si pjesë e kontributorëve të tij, për lexuesin e shtypit ushtarak do të na flasë Prof. Asoc. Dr. Sybi Musollari.

Doktor Sybi Musollari: në shtator 1968, filloi si ndihmësmjek në regjimentin e ndërlihdjes Tiranë deri në vitin 1971, më pas me urdhër të ministrit të Mbrojtjes vishet oficer ndihmësmjek dhe punon në të njëjtin repart. Ndjek fakultetin e mjekësisë në degën Mjekësi e Përgjithshme, duke mbaruar me rezultate të shkëlqyera.

Nga viti 1978 deri 1981 punon si mjek i përgjithshëm në brigadën e Tankeve. Në vitin 1981 transferohet në Spitalin e Përgjithshëm Ushtarak Tiranë, në repartin e sëmundjeve të mushkërive. Në vitin 1984 fillon po në Spitalin Ushtarak si shefi repartit pneumologjisë dhe pneumolog e alergolog.

Në vitin 1988 vazhdon punën si shefi i repartit të terapisë dhe pneumolog. Në vitin 1990 mbron temën shkencore për Kandidat i Shkencave Mjekësore për sëmundjet e mushkërive.

Gjatë ushtrimit të profesionit të tij me arritje të larta, është dekoruar për punë shkencore 2 herë nga Kuvendi Popullor i R.P.SH. Ka botuar shumë artikuj në organet shëndetësore, sidomos në vitet 1985 -1990. Ka marrë pjesë në kongrese ndërkombëtare për sëmundjet e mushkërive organizuar nga Lofarma Milano, në Lisbonë, më pas në Venecia, Itali etj.


Cilat ishin prioritetet e Spitalit Ushtarak, sipas etapave të zhvillimit të mjekësisë ushtarake?

Prioriteti kryesor në kohën e luftës ishte të përballo-hej me sukses fluksi i madh i të sëmurëve dhe të plagosurve në fushën e luftës. Kjo detyrë u realizua me sukses në saje të punës së palodhur të personelit mjekësor dhe dijeve shkencore që kishin marrë mjekët në shkollat perëndimore. Është një fakt interesant që të gjithë mjekët që u aktivizuan në luftë, dhe që ishin mbi 100, patën mbaruar shkollën në perëndim.

Prioritet i spitalit qendror të ushtrisë nga vitet 1944 e deri në vitin 1958 kanë qenë në dy drejtime: i pari të përmirësonte nivelin e shërbimit mjekësor në mjekimin e të sëmurëve, të mjekoheshin dhe rehabilitoheshin të plagosurit dhe invalidët e kohës së luftës; dhe orientimi i dytë ishte lufta kundër sëmundjeve infektive si tifo abdominal, tifo ekzantematike, fruthi, malaria dhe veçanërisht tuberkulozi. Theksoj se në ato vite këto sëmundje ishin në formë epidemie dhe shkaktonin shumë dëme në shëndetin e popullit dhe të ushtrisë.

Cilët kanë qenë disa prej drejtuesve të tij ndër vite?

Në vitin 1945 u ngrit sanatoriumi i parë në Tiranë, me 720 shtretër, ku mjekoheshin të sëmurët me TBC dhe Spitali Ushtarak në kuadër të luftës kombëtare kundër TBC organizoi nëpërmjet Qendrës Radiologjike nën drejtimin e Dr. Ismail Tartari, Dr. Lavdim Gjoncaj dhe Dr. Manxhar Qendro, depistimin masiv në radhët e ushtrisë për të zbuluar dhe mjekuar rastet e reja me TBC. Kjo betejë vazhdoi deri në vitin 1990, duke shkuar në çdo cep të Shqipërisë, ku ishin



vendosur efektivat ushtarakë dhe duke bërë radiografi të seleksionuar të të sëmurëve për t'i dërguar për mjekim të mëtejshëm në spital.

Mjekët që kanë punuar në spitalin qendror ishin Dr. Sinan Imami, Dr. Osman Jonuzi, Dr. Hiqmet Dibra, që më vonë u bë Dekan i Fakultetit të Mjekësisë dhe shef i Neurologjisë Kombëtare.

Dr. Nazmi Shehu, që më pas u emërua shef i Traumatologjisë në Spitalin Ushtarak, Dr. Koço Gliozheni, që më vonë u emërua shef i Maternitetit të Tiranës, Dr. Grigor Daiu, i cili u emërua më pas shef i Shërbimit Infektiv në Spitalin Ushtarak, Dr. Petro Cani, kirurg që më vonë u emërua shef i Kirurgjisë së Spitalit Civil, Dr. Petraq Progrid, që më pas u emërua shef i Shërbimit në Poliklinikën e Spitalit Ushtarak etj.

Për herë të parë në traumatologji nga Dr. Nazmi Shehu u hap dhomë reanimacioni për të sëmurët e shokuar.

Në vitin 1947 u bë urografia e parë dhe në vitin 1951 u bë bronkografia e parë. Po këtë vit, Dr. Petro Cani kreu operacionin e parë në mushkëri.

Spitali ushtarak u bë njësi bazë e organizimit të veprimtarisë shkencore në fushën e mjekësisë ushtarake. Po në vitin 1953 u mbajt dhe një sesion shkencor me tema kryesisht klinike, që i shërbenin punës së përditshme.

Në vitin 1973, drejtor u emërua Dr. Veli Toto, që ishte diplomuar në Çekoslovakia për kirurg urolog dhe qëndroi në këtë detyrë deri në vitin 1991.

Më vonë drejtorë të Spitalit Ushtarak kanë qenë Dr. Perlat Hodo, Dr. Ëngjëll Mastori, Dr. Ilir Kajo, Dr. Mihal Kerci, Dr. Luan Nikollari, Dr. Bedri Muho.

A mund të na bëni një rrugëtim nëpër historinë dhe zhvillimin e tij?

Nga viti 1958 deri në vitin 1968 spitali qendror i ushtrisë u transferua në Laprakë, në ndërtesën ku është dhe sot.

Spitali kishte një kapacitet prej 400 shtretër. Zhvendosja e spitalit në këtë ndërtesë krijoi kushtet për një punë shumë të kualifikuar mjekësore sepse kishte infrastrukturë të një spitali perëndimor me të gjitha repartet e duhura.

U emërtua si Spital i Përgjithshëm Ushtarak dhe sfida kryesore ishte rritja e nivelit shkencor të mjekimit të të sëmurëve të shtuar dhe ngritja e spitaleve ushtarake nëpër rrethe sipas vendosjes të reparteve të ushtrisë. Nën kujdesin e spitalit u ngritën rreth 14 spitale ushtarake të reparteve të cilët u kompletuan me mjekë kirurgë, mjekë të përgjithshëm, farmacistë, dhe dentistë, si dhe disa raste radiologë.

Për rritjen e nivelit shkencor të mjekimit të të sëmurëve, në spital u ngrit repartit i kirurgjisë së përgjithshme me Dr. Ismail Feta, një kirurg i talentuar që i dha emër Spitalit Ushtarak. Dr. Ismaili ishte personalitet në fushën e mjekësisë, ai u bë i njohur në gjithë vendin për punën e tij shumë cilësore,



sjelljen shembullore dhe nivelin e lartë shkencor të trajtimit të të sëmurëve. Dr. Ismaili punoi deri në vitin 1990 dhe gjithë jetën e tij ia kushtoi të sëmurëve.

Në repartin e traumatologjisë u kryen operacionet e para me osteosintezë nga Dr. Petraq Xoxe.

Në këtë repart punoi Dr. Spiro Dede, kirurg i diplomuar në Leningrad dhe që bëri operacionin e parë në zemër me ndihmën e Prof. Petrit Gaçes, gjithashtu bëri operacione në mushkëri në mënyrë të vazhdueshme, sidomos pas kthimit nga specializimi në Kinë.

U ngrit reparti i Reanimacionit me shef Dr. Mihal Prifti, specializuar në Rusi. Reparti i Urologjisë, me shef Dr. Veli Toto.

Në vitin 1962 u krijua reparti Kardiologjisë me shef dr. Hajro Shytin.

Reparti Okulistikës me Dr. Skënder Sinojmerin, i cili bëri operacione shumë të ndërlikuara për kohën.

Reparti Otorinolaringologjisë, me Dr. Besnik Budo, që bëri operacione plastike të membranës së veshit që nuk ishin bërë deri atëherë.

Reparti i Nefrologjisë, me Dr. Thoma Mele, kardiolog i specializuar në Rusi.

Reparti Neurologjisë, me shef Hiqmet Dibrën, që më vonë do të bëhej Dekan i Fakultetit të Mjekësisë.

Reparti i Sëmundjeve Infektive, me shef Dr. Qatip Kapllanin, specializuar jashtë.

Reparti i Dermatologjisë, me shef Dr. Vasil Gjylametin.

Reparti i Laboratorëve, me shef Dr. Vaskë Mukin.

Reparti i Traumatologjisë, me shef Dr. Nazmi Shehun.

Periodha nga 1968 deri 1974 kishte prioritet rritjen e nivelit shkencor të mjekëve dhe organizimin e punës mjekësore shkencore në funksion të perfeksionimit të shërbimit shëndetësor në kohë lufte, punën eksperimentale me kafshë për dhënien e ndihmës së parë, në të sëmurë me dëmtime nga armët e dëmtimit në masë, si arma radioaktive dhe lëndët helmuese luftarake. Për këtë qëllim, nën kujdesin e shtetit, u dërguan në Kinë 2 grupe mjekësh nga 10 veta për specializim njëvjeçar, ku gjithsej shkuan 22 mjekë.

Sa shërbime janë ofruar dhe cilat ishin ato?

Me ardhjen e mjekëve nga Kina, Spitali Ushtarak u bë spitali me pothuajse të gjithë personelin e studiuar jashtë, kjo e rriti shumë nivelin e mjekimit të pacientëve. U vunë në zbatim metoda të reja të mjekimit.

Kështu u rrit cilësia e operacioneve të përgjithshme, u hap reparti i Djegieve-Plastikës me Dr. Gëzim Pepin, ku aplikohesh plastika e të sëmurëve me djegie. Reparti i Reanimacionit me Dr. Agron Egro, u vu në përdorim narkoza endotrakeale dhe u rrit cilësia e reanimacionit.

Reparti i Traumatologjisë, me Dr. Petraq XoXen dhe Halo Kërrin, ku realizoheshin operacione të cilësisë të lartë, me ndërhyrje në nerva e tendina.

Reparti i Neurologjisë, me shef Dr. Agim Kolasi, reparti i Okulistikës dhe i Otorinolaringologjisë, me Dr. Shkëlqim Kushova, bënë operacione të vështira në vesh.

Reparti i Kardiologjisë, me Dr. Kristaq Roko, kardiolog, i cili me vonë hapi Reanimacion Kardiologjie me 5 monitorë, një shërbim që deri atëherë nuk ishte në vendin tonë, reparti i Neurologjisë, me Dr. Rexho Kardhashi, që përmirësoi mjekimin e epilepsive.

Reparti i Gastroenterologjisë, me shef Dr. Shefki Guma, i cili vuri në jetë metoda të reja të mjekimit të ulcerës.

Dhe mbi të gjitha, u ngrit reparti i mbrojtjes nga armët e dëmtimit në masë, si ai i Radiobiologjisë dhe Toksikologjisë, këto dy reparte bashkëpunuan shumë me Qendrën Eksperimentale me kafshë, të spitalit duke i rrezatuar me lëndë radioaktive dhe më pas duke i mjekuar për të formuluar protokolle të mjekimit për kohë lufte. Po kështu dhe reparti i toksikologjisë punoi shumë në eksperimentimin e mjekimit nga lëndët helmuese luftarake.

Reparti i Radiobiologjisë u drejtua nga Dr. Gjergji Aleksii dhe Dr. Spiro Mëshilli. Reparti i Toksikologjisë u drejtua nga Dr. Bexhet Refatllari, mendoj të ndalem tek ky personalitet dhe shkencëtar i mjekësisë ushtarake që punoi me devocion për të vënë në jetë prodhimin në vend të Paketës Individuale Kundër-kimike. Kjo ishte një paketë që përbante medikamente që neutralizonin lëndën helmuese – luftarake, në rast helmimi nga këto lëndë. Me këto paketa do të pajiseshin të gjithë efektivet e ushtrisë e populli në rast të një agresioni kimik. Këto paketa në vitin 1971 skaduan dhe nga Këshilli i Mbrojtjes iu vu detyrë repartit të Toksikologjisë dhe Institutit të Kimisë Ushtarake për t'u prodhuar në vend. Ishte shumë e vështirë por shumë e domosdoshme. Këtë detyrë e kreu i palodhuri Dr. Bexhet Refatllari. Ai punoi 1 vit së bashku me inxhinierët e kimisë dhe e prodhoi. Në eksperimentet që u bënë me kafshë rezultoi e suksesshme. Dr. Bexheti më ka treguar se, kur ishte në Kinë, teknologjinë e prodhimit të paketës nuk e jepnin sepse ishte sekret, por unë, thoshte ai, për ditë e pyesja profesorin që punonte me mua për probleme që në mënyrë indirekte kishin të bënin me



prodhimin e paketës. Profesori si dashamirës i vendit tonë më dha shumë të dhëna, të cilat kur u ktheva më shërbyen për të zgjidhur një problem të madh shtetëror që kishte të bënte me gatishmërinë dhe shëndetin e Forcave tona të Armatosura.

Çfarë ndryshimesh solli periudha mes viteve 1973 - 1991?

Në vitin 1973, spitalit i jepet emri Institut i Kërkimeve Mjekësore Ushtarake IKMU, me drejtor Dr. Veli Toto, doktor që kishte bërë shkollën dhe specializimin në Çekoslovaki, qëndroi deri në 1990.

Cilat ishin sfidat kryesore dhe sa e vështirë ishte, duke ditur problematikat e kohës?

Sfidat e Institutit ishin: Të fuqizohej puna shkencore, eksperimentale në funksion të mjekësisë. Krijimi i Institutit kërkonte një organizim të ri, kërkesa më të larta të punës kërkimore shkencore, me metoda të reja diagnostikimi e mjekimi dhe bashkëpunimi më të gjerë me të gjitha institucionet shkencore të vendit. Vendimi i Këshillit të Ministrave përcaktonte drejtimet kryesore të punës së Institutit, ku më kryesoret ishin trajtimi i mjekimit, ku vendin kryesor e zinte profilaksia, puna kërkimore dhe organizimi dhe përgatitja e strukturave për kohë lufte. Duhet nënvizuar fakti që, puna kërkimore shkencore dhe ajo kurative zhvilloheshin paralelisht të gërshetuara me njëra - tjetrën.

Sipas vendimit të Këshillit të Ministrave, efektiv i spitalit përbëhej nga 438 punonjës dhe kapacitet shtrimi prej 400 shtretërish, numri i shtrimeve arriti deri 11 000 në vit. Në sektorin e Kirurgjisë, pas vitit 1980 janë kryer 1 400 operacione në vit.

U ngrit Spitali Qendror i Luftës me të gjitha pajisjet e nevojshme në Bizë- Martanesh, u krijua Këshilli Shkencor i Institutit, shumica e mjekëve të rinj që kishin ardhur nga Fakulteti i Tiranës mbrojtën tema shkencore pranë Këshillit Shkencor të Institutit dhe në bashkëpunim me Këshillin Shkencor të Fakultetit të Mjekësisë, të gjitha temat i përshtateshin mjekësisë së kohës së luftës.

Të kualifikoheshin dhe t'u jepeshin detyra studimore shkencore klinike e eksperimentale mjekëve të rinj që kishin ardhur nga Fakulteti i Tiranës. Kështu në kirurgji erdhi Dr. Xhafer Qamirani, reanimacion Dr. Mihal Kerci e Dr. Viktor Kotoni, Dr Islam Dauti, në djegie Dr. Dilaver Bajrani, në ORL Dr. Kujtim Karafili e Dr Ndue Bardhi, në okulistike Dr. Thanas Kulo, në kardiologji Dr. Anila Ligaci, kardiologji Dr. Vaso Alimerko, në neurologji Dr. Qamil Koni, në neurologji Dr. Sybi Musollari, në pneumologji Dr. Zini Sula, në toksikologji Dr. Zija Jace, në laborator Dr. Sulejman Mena, në infektiv Dr. Ismet Hasko.

Shumica e këtyre mjekëve kanë mbrojtur tema shkencore pranë Këshillit Shkencor të Institutit dhe Fakultetit të Mjekësisë.

Për të rritur më tej nivelin shkencor të mjekëve të rinj u mor Urgjenca e të sëmurëve e Tiranës, një herë në javë nga kirurgjia dhe një herë në javë terapia. Kjo ndikoi në rritjen e nivelit tekniko - shkencor të trajtimit të të sëmurëve rëndë dhe u përballua me sukses.

Dr. Sybiu, a pati mes bluzave të bardha të atyre viteve dhe pjesëmarrje të vajzave? Dhe a mundën ato të arrijnë sukseset e mjekëve të nderuar?

U rrit shkalla e emancipimit të gruas në ushtri, sepse erdhën 5 mjekë gra si Dr. Mejte Bogdani në pneumologji, Dr Hiqmete Dini në reumatologji, Dr. Tatjana Milo në gastroenterologji, Dr. Violeta Ristani në okulistike dhe Dr. Haxhire Eshja në fizioterapi.

Spitali Ushtarak ka pritur pacientë vetëm nga Forcat e Armatosura, apo dhe civilë?

Spitali i Përgjithshëm Ushtarak gjatë gjithë viteve ka qenë në pararojë të mjekimit të pacientëve, jo vetëm nga radhët e ushtrisë, por dhe popullsisë civile.

Sa nga pritsmëritë e pacientëve përmbusheshin nga shërbimet e ofruara në spital?

Mendoj se spitali i ka përmbushur të gjitha kërkesat, si në volum dhe cilësi. Spitali ka bërë asistencë vetëm për forcat e armatosura apo dhe civilë, sepse në vitin 1965 me urdhër të ministrit të Mbrojtjes u lejua mjekimi i veteranëve të luftës, ish-ushtarakëve, familjet e ushtarakëve.

Me marrjen e urgjencës, kontingjenti i të sëmurëve civilë u rrit shumë.

Unë jam krenar që kam qenë pjesë e atij kolektivi dhe kam dhënë kontributin tim në sukseset e trajtimit të të sëmurëve dhe rritjen e nivelit shkencor të mjekësisë ushtarake.

Jam i ndërgjegjshëm se për sa kam përshkruar më sipër është vetëm një pjesë e vogël e asaj veprimtarie të shumanshme, sa humanitare aq edhe e suksesshme në fushën e mjekësisë ushtarake.

Doktor Sybiu, si pjesë e elitës së mjekëve dhe drejtuesve të Spitalit Ushtarak, ju falënderoj për këtë intervistë, mes të cilës sollëm për lexuesin më të ri pak histori nga jeta dhe rrugëtimi i Spitalit Ushtarak, si një prej institucioneve më të rëndësishëm të kohës.

Rusia kundër Ukrainës, lufta brutale e agresionit

*Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s në Parlamentin
e BE-së: Qëndroni në kursin për Ukrainën*

Përshtati: MIMOZA GOLIKJA

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, u takua me grupin e Aleancës Progresive të Socialistëve dhe Demokratëve në Parlamentin Europian, të udhëhequr nga presidenti i tyre Iratxe García Pérez, më 27 shtator 2022.

Stoltenberg deklaroi se pushtimi i Ukrainës nga Rusia ka shkaktuar konfliktin më të madh në Europë që nga Lufta e Dytë Botërore dhe ka sfiduar rregullat dhe vlerat themelore. Ai dënoi fuqimisht "pseudoreferendumet" e Rusisë të organizuara në pjesë të Ukrainës, mobilizimin e pjesës, si dhe goditjet bërthamore si përshkallëzim të konfliktit.

Sekretari i Përgjithshëm tha se NATO nuk është palë në konflikt, edhe pse Moskë tani po përpaket ta paraqesë atë si një luftë midis Rusisë dhe NATO-s. Në fakt, Sekretari i Përgjithshëm e bëri të qartë: "kjo është lufta e agresionit të Rusisë kundër Ukrainës dhe ne po mbështesim Ukrainën të mbrohet". Ai theksoi se e drejta për vetëmbrojtje është e sanksionuar në Kartën e OKB-së dhe Europa dhe Amerika e Veriut duhet të mbajnë kursin, pavarësisht krizës energjetike të shkaktuar nga Rusia.

Stoltenberg tha se NATO po monitoron nga afër situatën në Detin Baltik, aleatët po shqyrtojnë rrjedhjet e gazit nga të dy tubacionet "Nord Stream" dhe gjithashtu, po shkëmbejnë informacione me Finlandën dhe Suedinë.

Diskutimi me grupin socialist dhe demokrat është pjesë e angazhimeve të rregullta të Sekretarit të Përgjithshëm me ligjvënësit e BE-së, në kuadër të partneritetit strategjik të NATO-s me BE-në.

Rusia kundër Ukrainës, lufta brutale e agresionit

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, tha se e kishte vizituar shumë herë Parlamentin Europian, institucionet europiane dhe grupe të ndryshme të partive politike, por asnjëherë socialistët dhe demokratët, ishin fjalët hyrëse në takimin e Grupit të Aleancës Progresive të Socialistëve dhe Demokratëve në Parlamentin Europian. "Mendoj se tani është koha që të takohem me ju dhe të ndihem si në shtëpinë time, mes miqsh", - tha ai për të pasur "këtë mundësi për t'u ulur dhe për të trajtuar" një çështje shumë të vështirë, të rëndësishme, serioze siç është lufta në Ukrainë, "lufta brutale e agresionit. Rusia kundër Ukrainës". Por Sekretari i Përgjithshëm tha se për të është më rëndësi fakti që NATO dhe Bashkimi Europian kanë shumë të përbashkëta. "Ne jemi dy institucione të ndryshme, dy organizata të ndryshme, por ndajmë të njëjtat vlera, ndajmë të njëjtin rajon dhe gjithashtu ndajmë shumë anëtarë të njëjtë. Kur Finlanda të hyjë në NATO, 96% e njerëzve që jetojnë në BE, do të jetojnë në një vend të NATO-s, të mbrojtur nga NATO. Pra, do të thotë se ne kemi vërtet shumë të përbashkëta. Sigurisht, që kemi të përbashkët edhe faktin që ndajmë të njëjtin rajon, ndajmë të njëjtat kërcënime dhe sfida dhe ne shohim Ukrainën, një fqinj të NATO-s, një fqinj të BE-së, atë që ndodh atje që ka rëndësi për të gjithë ne."

Stoltenberg njoftoi se vetëm pak orë më parë kishte folur me Presidentin Zelenskyy, të cilit i kishte thënë sërish se aleatët e NATO-s, partnerët, Europa, Amerika e Veriut, qëndrojnë në solidaritet me të dhe admirojnë guximin që populli ukrainas ka treguar, forcat e armatosura ukrainase, dhe gjithashtu, forcën dhe vendosmërinë e lidershit politik. "Ajo që ne shohim tani është një luftë brutale agresioni. Është një shkelje e hapur e ligjit ndërkombëtar dhe është një pushtim absolutisht i pajustificuar i një fqinji. E them këtë sepse është jashtëzakonisht e rëndë-



sishme të kuptojmë se nëse nuk reagojmë kundër kësaj lufte, këtij pushtimi brutal, atëherë ne në fakt po rrezikojmë jo vetëm sigurinë e Ukrainës, por edhe sigurinë tonë. Sepse atëherë mësimi i mësuar për Presidentin Putin dhe udhëheqësit e tjerë autoritarë do të jetë se nëse përdorin forcën ushtarake, shkelin ligjin ndërkombëtar, ata marrin atë që duan. Dhe kjo është e keqe për Ukrainën, por është gjithashtu e keqe për ne", - theksoi shefi i NATO-s. "Dhe kjo, - tha ai, - është arsyeja pse NATO ka rritur dhe mbështetur Ukrainën në mënyrën që e kemi bërë gjatë muajve të fundit. Kjo është gjithashtu serioze, jo vetëm sepse ka të bëjë me sigurinë, por edhe, natyrisht, degëzimet, pasojat e luftës dhe fakti që Rusia tani po e kthen në armë energjinë, duke e përdorur atë si mjet në një konflikt të armatosur, kjo ka pasojat për të gjithë ne me një rritje të mprehtë të çmimeve të energjisë dhe gjithashtu, me rritje të inflacionit".

NATO po monitoron nga afër situatën në Detin Baltik

Ndërkohë NATO ndjek me shumë shqetësim edhe raportet që vijnë nga Deti Baltik, ku po shihet rrjedhjet nga të dy tubacionet si nga "Nord Stream 2" ashtu edhe nga "Nord Stream 1". "Kjo është diçka që ne e monitorojmë nga afër në NATO. Natyrisht, ne jemi në kontakte të ngushta me aleatët e NATO-s përfshirë, Danimarkën, por edhe me Suedinë, e cila di të bëhet së shpejti anëtarë e NATO-s. Kjo është diçka që është jashtëzakonisht e rëndësishme për të marrë të gjitha faktet në tryezë, prandaj, kjo është diçka që do ta shqyrtojmë nga afër në orët në vijim dhe në bashkëpunim të ngushtë me aleatët e NATO-s dhe partnerin ose të ftuarin tonë, që së shpejti do të bëhet anëtar i NATO-s, Suedinë", - tha Stoltenberg, duke u përqendruar më tej në detyrat dhe përgjegjësitë kryesore të NATO-s, si dhe në bashkëpërgjegjësinë e BE-së, siç tha ai.

Mbështetja për Ukrainën, parandalim dhe mbrojtje

NATO ka dy detyra thelbësore kur bëhet fjalë për luftën në Ukrainë. Njëra është të sigurojë mbështetje për Ukrainën dhe detyra tjetër është të parandalojë përshkallëzimin e konfliktit.

"Së pari, për mbështetjen për Ukrainën, ajo që ka bërë NATO dhe kemi parë gjatë javëve të fundit, ajo është një mbështetje e paprecedentë, me mbështetje ushtarake, armë, municione, mbështetje financiare, mbështetje humanitare, dhe

gjithashtu, aleatët e NATO-s, BE-së dhe të tjerët kanë zbatuar sanksione të paprecedentë ndaj Rusisë, për të siguruar që ajo të paguajë një çmim të rëndë për këtë luftë brutale kundër Ukrainës", - tha Sekretari i Përgjithshëm. Ajo që ne shohim tha ai është se kjo mbështetje po bën ndryshimin në fushën e betejës çdo ditë. "Presidenti Putin ka bërë një gabim të madh strategjik. Ai mendonte se ishte në gjendje të fitonte mbi Ukrainën brenda disa ditësh, për të marrë kontrollin mbi Kiev brenda disa ditësh. Ai ishte absolutisht i gabuar. Ai është dëbuar nga veriu, zonat përreth Kievit. Pastaj ai filloi një ofensivë në Donbas. Tani ajo ofensivë është bllokuar nga forcat e armatosura të Ukrainës. Dhe në fakt, forcat e armatosura ukrainase kanë mundur të rimarrin territorin", - tha Sekretari i Përgjithshëm. "Kjo është, natyrisht, para së gjithash për shkak të guximit, aftësive, vendosmërisë së forcave të armatosura të Ukrainës, por kjo nuk do të ishte e mundur pa mbështetjen e konsiderueshme nga vendet e ulura në këtë sallë, nga të gjithë aleatët e NATO-s dhe BE-ja. Ajo që duhet të kuptojmë, se luftërat janë të paparashikueshme, kështu që askush nuk mund të thotë se sa do të zgjasë kjo luftë dhe sigurisht, ne duhet të kuptojmë se kjo mund të vazhdojë për një kohë të gjatë, prandaj, ne duhet të jemi të përgatitur të vazhdojmë t'i ofrojmë mbështetje Ukrainës për një kohë të gjatë. Prandaj, ne gjithashtu duhet të rrisim prodhimin. U takova me drejtorët e armatimit të NATO-s këtë mëngjes dhe tani po diskutojmë se si ne, në bashkëpunim me BE-në, mund të sigurojmë që të prodhojmë më shumë, në mënyrë që të mund të ofrojmë më shumë, si për të siguruar parandalimin dhe mbrojtjen tonë, por edhe për të ofruar mbështetje për Ukrainën".

Parandalim i përshkallëzimit të konfliktit

"Më duhet të pranoj se është një paradoks që ne si liderë politikë duhet të shpenzojmë kaq shumë kohë, kaq shumë energji, kaq shumë para për mbrojtje. Sepse ne të gjithë do të donim t'i shpenzonim ato para për arsim, shëndetësi, infrastrukturë, në vend që të rrisim prodhimin e mbrojtjes. Por realiteti është se ne nuk kemi asnjë zgjedhje. Sepse kur përballemi me agresionin, siç e shohim në Ukrainë, në fakt ka mbrojtje dhe vetëm mbrojtje që mund ta ndalojë atë lloj agresioni.

Dhe kjo është arsyeja, - tha Sekretari i Përgjithshëm, - pse jemi në këtë situatë tragjike, ato para që duhet të ishin përdorur për diçka tjetër tani duhet të përdoren për të mbështetur Ukrainën, sepse nëse ata humbasin, kjo do të ishte keq për të gjithë ne, - tha ai. - Pra, mesazhi i parë është se duhet të vazhdojmë të mbështesim Ukrainën. Mesazhi tjetër është se duhet të parandalojmë që kjo luftë të përshkallëzohet. Ne kemi parë, në fakt, një përshkallëzim gjatë ditëve të fundit, të shkaktuar nga Rusia, të shkaktuara nga referendumet e rreme që Rusia po organizon tani në katër rajone të Ukrainës, por të kombinuara edhe me retorikën bërthamore të Presidentit Putin dhe udhëheqësve të tjerë rusë. Ky është një përshkallëzim i konfliktit. Do të shkaktojë më shumë vdekje, më shumë vuajtje dhe sigurisht, referendumet e rreme, retorika bërthamore, e kombinuar gjithashtu me mobilizimin e forcave të armatosura në Rusi, e gjithë kjo është një përshkallëzim serioz i konfliktit. Mesazhi ynë është se çdo përdorim i armëve bërthamore është absolutisht i papranueshëm. Do të ndryshojë tërësisht natyrën e konfliktit dhe Rusia duhet ta dijë se një luftë bërthamore nuk mund të fitohet dhe nuk duhet të luftohet kurrë". Stoltenberg tha se edhe pse nuk ka gjasa që armët bërthamore të përdoren, "kur shohim atë lloj retorike bërthamore përsëri dhe përsëri nga Rusia, nga Presidenti Putin, është diçka që duhet ta marrim seriozisht. Prandaj, ne po përcjellim mesazhin e qartë se kjo do të ketë pasojat të rënda për Rusinë dhe se një luftë bërthamore nuk duhet të bëhet kurrë".

NATO nuk është palë në konflikt

Mesazhi tjetër që përcolli shefi i NATO-s ishte se ka një tjetër lloj përshkallëzimi, dhe ky është një përshkallëzim përtej Ukrainës. "Lufta që po vazhdon tani në Ukrainë është e keqe dhe një tragjedi për popullin ukrainas, por sigurisht, një luftë e plotë midis NATO-s dhe Rusisë do të ishte edhe më e keqe, - tha ai. - Prandaj, ne duhet të sigurohemi që kjo të mos evoluojë në një luftë të plotë në Europë dhe ne e bëjmë këtë duke qenë shumë të qartë se NATO dhe aleatët e NATO-s nuk janë palë në konflikt. Ajo që ne bëjmë është të mbështesim Ukrainën, por nuk kemi trupa të NATO-s në Ukrainë, nuk kemi nevojë për avionet të NATO-s në ajër, por ne ofrojmë mbështetje për Ukrainën. Kjo do të thotë të mos jesh palë në konflikt. Ukraina ka të drejtën për vetëmbrojtje që është e sanksionuar në Kartën e OKB-së. Çdo komb që sulmohet ka të drejtë të mbrojtë veten dhe ne po e mbështesim Ukrainën në mbrojtjen e kësaj të drejte. Pra, ne nuk jemi palë në konflikt. Unë e shoh, ose ne e shohim, që Rusia tani po përpaket ta portretizojë këtë konflikt si një luftë midis Rusisë, NATO-s, Perëndimit. Jo, nuk është një luftë mes NATO-s dhe Rusisë. Është një luftë agresioni nga Rusia kundër Ukrainës. Dhe ne po mbështesim Ukrainën në mbrojtjen e saj. Kjo nuk na bën neve palë në konflikt. Është e rëndësishme që ne ta përcjellim atë mesazh". Nga ana tjetër NATO po parandalon gjithashtu përshkallëzimin e konfliktit në territorin e Aleancës duke dërguar një mesazh shumë të qartë se nëse një aleat i NATO-s sulmohet, atëherë kjo do të shkaktojë një përgjigje nga e gjithë Aleanca. Ne e kemi bërë këtë duke

rritur ndjeshëm praninë e trupave të NATO-s, veçanërisht në pjesën lindore të Aleancës, në vendet baltike, por edhe në Poloni, Rumani, Sllovaki, në pjesën lindore të Aleancës. Më shumë se 40 000 trupa tani nën komandën e NATO-s, të mbështetur nga forca të konsiderueshme detare dhe ajrore dhe ne nuk e bëjmë këtë për të provokuar një konflikt, por për të parandaluar një konflikt. Detyra e NATO-s është të ruajë paqen. Kjo është detyra kryesore e të gjithë Aleancës, ne jemi një aleancë mbrojtëse. Por duke rritur praninë, ne po sigurohemi që të mos ketë vend për llogaritje të gabuara, keqkuptime në Moskë për vullnetin tonë, gatishmërinë tonë për të mbrojtur çdo pëllëmbë të territorit të NATO-s. Dhe për sa kohë që kjo është e qartë, aleatët e NATO-s nuk do të sulmohen dhe konflikti nuk do të përshkallëzohet, sepse ne jemi atje për të mbrojtur njëri-tjetrin dhe duke qëndruar së bashku jemi më të sigurt dhe më të fortë". Stoltenberg tha se këto janë dy detyrat kryesore të NATO-s, të sigurojë që, "ne të mbështesim Ukrainën, të bëjmë gjithçka që mundemi për të parandaluar përshkallëzimin, si përshkallëzimin në një konflikt bërthamor në Ukrainë, por sigurisht, edhe përshkallëzimin përtej Ukrainës duke përfshirë aleatët e NATO-s dhe Rusinë".

Amerika e Veriut dhe Europa duhet të qëndrojnë së bashku

Ndërkohë ajo që kemi parë gjatë gjithë këtij konflikti është rëndësia e lidhjes transatlantike, Amerikës së Veriut dhe Europës dhe lidhshin amerikan që qëndrojnë së bashku. Natyrisht, aleatët europianë janë rritur dhe aleatët europianë po bëjnë më shumë. Por ne shohim se forca e Shteteve të Bashkuara, por edhe e mbështetur nga Kanada, bën një ndryshim të madh. Prandaj, unë mendoj se lufta në Ukrainë thjesht nxjerr në pah edhe një herë se Amerika e Veriut dhe Europa duhet të qëndrojnë së bashku. Kjo është mënyra më e mirë për të ruajtur paqen dhe për të parandaluar konfliktin e mëtejshëm ose përshkallëzimin e konfliktit. Ne jemi duke punuar ngushtë me BE. Unë mendoj se ne shohim se si BE dhe NATO, po plotësojnë njëri-tjetrin. BE ka bërë shumë për t'i dhënë mbështetje Ukrainës, për të zbatuar sanksionet, dhe natyrisht, së bashku me aleatët e NATO-s, duke mos qenë anëtarë të BE-së, kjo është një përgjigje e fortë dhe e bashkuar nga Amerika e Veriut dhe nga Europa. Por në fakt edhe partnerët e tjerë anëmbanë botës e kanë bërë për të siguruar që Putini nuk shpërblehet duke përdorur forcën kundër një kombi të pavarur e sovran. Sigurisht, ne po paguajmë një çmim si europianët: kostot e energjisë, inflacioni, çmimet që paguajmë për armët, municionet, mbështetjen financiare që i ofrojmë Ukrainës. Por ndërsa mbështetja jonë matet me para, çmimi që po paguajmë ukrainasit matet me gjak. Prandaj, ne duhet të përgatitemi për një dimër të vështirë, të jemi të përgatitur të vazhdojmë të ofrojmë mbështetje, sepse alternativa, të mos i japim mbështetje Ukrainës, na bën të rrezikojmë të paguajmë një çmim shumë më të lartë. Atëherë realisht rrezikojmë një situatë të rrezikshme në Europë që do të na bëjë edhe më të pambrojtur.

NATO e përgatitur të frenojë dhe të mbrohet nga përdorimi i taktikave hibride

Deklaratë e Këshillit të Atlantikut të Veriut për dëmtimin e tubacioneve të gazit

Dëmtimi i tubacioneve “Nordstream 1” dhe “Nordstream 2” në ujërat ndërkombëtare në Detin Baltik është një shqetësim i thellë. Të gjitha informacionet e disponueshme aktualisht tregojnë se ky është rezultat i veprimeve të qëllimshme, të pamatura dhe të papërgjegjshme të sabotimit. Këto rrjedhje po shkaktojnë rreziqe për transportin dhe dëme të konsiderueshme mjedisore. Ne mbështesim hetimet që po zhvillohen për të përcaktuar origjinën e dëmit.

Ne, si aleatë, jemi zotuar të përgatitemi, të frenojmë dhe të mbrohemi kundër përdorimit shtërngues të energjisë dhe taktikave të tjera hibride nga aktorët shtetërorë dhe jo shtetërorë. Çdo sulm i qëllimshëm kundër infrastrukturës kritike të Aleatëve do të përballëj me një përgjigje të bashkuar dhe të vendosur.



SEKRETARI I PËRGJITHSHËM I NATO-S MBLEDH ZYRTARËT E LARTË TË PROKURIMIT TË ALEANCËS

Rritja e rezervave të NATO-s, takim i jashtëzakonshëm i CNAD

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, thirri një takim të jashtëzakonshëm të Konferencës së Drejtorëve të Armatimeve Kombëtare (CNAD), më 27 shtator 2022, në selinë e NATO-s. Takimi u fokusua në implikimet e luftës së Rusisë kundër Ukrainës, duke përfshirë aftësitë e aleatëve dhe rezervat e municioneve.

Sekretari i Përgjithshëm u kërkoi aleatëve të vazhdojnë rimbushjen e rezervave sa më shpejt të jetë e mundur. “Rritja e stoqeve të NATO-s do të sigurojë që ne mund të vazhdojmë të mbështesim Ukrainën”, - tha ai. “Ne duhet të vazhdojmë të punojmë së bashku si aleatë të NATO-s dhe me industrinë për të rimbushur rezervat tona të municioneve dhe për t’i ofruar Ukrainës mbështetjen që i nevojitet, për aq kohë sa Ukraina ka nevojë për të”, - shtoi ai. Takimi trajtoi mënyrat në të cilat aleatët mund të kuptojnë më mirë çdo boshllëk në stoqe dhe t’i trajtojnë këto boshllëqe së bashku.

Misioni i CNAD është të mundësojë bashkëpunimin në ofrimin e aftësive të ndërveprueshme ushtarake. Ai siguron që forcat e NATO-s të kenë aftësi të fundit të disponueshme në çdo kohë.

Konferenca e Drejtorëve të Ar-



matimeve Kombëtare (CNAD) është komiteti i lartë i NATO-s përgjegjës për promovimin e bashkëpunimit midis vendeve në fushën e armatimeve. CNAD mbledh së bashku zyrtarët më të lartë kombëtarë përgjegjës për prokurimin e mbrojtjes në vendet anëtare dhe partnere të NATO-s. Ajo ka për detyrë të identifikojë mundësitë e bashkëpunimit për kërkimin, zhvillimin dhe prodhimin e pajisjeve ushtarake dhe sistemeve të armëve. Ajo i raporton drejtpërdrejt Këshillit të Atlantikut të Veriut.

CNAD mbledhet dy herë në vit në nivelin e Drejtorëve Kombëtarë të Armatimeve (NADREPs), nën kryesimin e Ndhmës Sekretarit të Përgjith-

shëm të NATO-s për Investimet e Mbrojtjes. Gjatë këtyre takimeve dyvjeçare, CNAD përcakton drejtimin e punës së Konferencës dhe mbikëqyr atë të strukturës vartëse të CNAD. Udhëzimet e përgjithshme sigurohen përmes Planit të Menaxhimit të CNAD, i cili përkthen objektivat strategjike të NATO-s në objektiva specifike për komunitetin e armatimeve dhe përcakton prioritetet për bashkëpunimin e përditshëm.

Takimet e rregullta në nivel të Përfaqësuesve të brendshëm të Drejtorëve Kombëtarë të Armatimeve (NADREPs) sigurojnë zbatimin e përditshëm të objektivave të CNAD.

“SHBA – Forumi Ekonomik i Rumanisë: Nga siguria në prosperitet”

Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s bën thirrje për forcimin e partneriteteve për të përshpejtuar inovacionin

Duke folur virtualisht në konferencën “SHBA – Forumi Ekonomik i Rumanisë: Nga siguria në prosperitet”, më 28 shtator 2022, Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm, Mircea Geoană, theksoi se forcimi i partneriteteve, jo më pak me sektorin privat, është thelbësor për të përshpejtuar inovacionin dhe për ta mbajtur NATO-n të fortë në një situatë më konkurruese dhe bota e rrezikshme.

Z. Geoană përshkroi më tej përgjigjen e NATO-s ndaj luftës së Rusisë kundër Ukrainës, duke përfshirë mbështetjen e fortë politike dhe praktike për Kievin dhe përmirësimin e mëdha në parandalimin dhe mbrojtjen e Aleancës.

Konferenca shënoi 25-vjetorin e partneritetit strategjik SHBA-Rumani, të cilin Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm e quajti si një “spirancë e politikës së jashtme dhe interesit kombëtar të Rumanisë”. Ajo u organizua nga Dhoma Amerikane e Tregtisë në Rumani, me mbështetjen e Ambasadës Amerikane në Bukuresht dhe Instituti Aspen në Rumani.

PROGRAMI I NATO-S, SHKENCA PËR PAQE DHE SIGURI (SPS)

Përdorimi i teknologjive kuantike për t’i bërë komunikimet të sigurta

Projektet inovative të udhëhequra nga shkencëtarët në NATO dhe vendet partnere po hapin terren të ri për të shfrytëzuar fuqinë e kuantit për t’i bërë komunikimet të pamundura për t’u përgjigjur hakuar. Zbatimi i këtyre teknologjive kuantike në sektorët e sigurisë dhe mbrojtjes mund të ndihmojë në sigurimin e transmetimit të informacionit në të ardhmen, duke e mbrojtur atë nga sistemet gjithnjë e më të avancuara të hakerimit dhe duke kontribuar në përpjekjet e NATO-s për të ruajtur avantazhin e saj teknologjik.

Projektet e kërkimit dhe zhvillimit të Programit të NATO-s “Shkenca për Paqe dhe Siguri” (SPS) kanë ekzaminuar aplikimet e teknologjive kuantike të lidhura me sigurinë, duke trajtuar tre fushat e tyre kryesore: informatikë, ndjeshmëri dhe komunikim. Llogaritja kuantike dhe sensori po përmirësojnë aftësitë e kompjuterëve dhe teknologjive të matjes në distancë në nivele që ata tradicionalisht nuk janë në gjendje t’i arrijnë. Në fushën e komunikimeve kuantike, aktivitetet SPS po tregojnë rezultatet më premtuese. Këto projekte zhvillojnë sisteme për enkriptimin dhe transmetimin e sigurt të informacionit duke përdorur shpërndarjen e çelësit kuantik (QKD) dhe kriptografinë post-kuantike (PQC). Njëpërmjet këtyre teknikave, ata i përgjigjen shqetësimeve në rritje të sigurisë në lidhje me teknologjitë e reja, siç janë kompjuterët kuantikë, të cilët mund të deshifrojnë komunikimet sekrete, duke parandaluar aksesin e paautorizuar.

Testimi i shpërndarjes së çelësit kuantik (QKD)

QKD është një metodë komunikimi kuantike për të ndarë çelësat e deshifrimin. Në këtë sistem, një mesazh i koduar dërgohet përmes rrjeteve tradicionale, ndërsa çelësat për dekriptimin e informacionit transmetohen përmes mjeteve kuantike. Në këtë mënyrë, vetëm marrësi i synuar mund të dekodojë mesazhin, duke e bërë të pamundur çdo përgjim. Duke aplikuar këtë metodë, një projekt SPS arriti të lidhë Italinë dhe Maltën me një lidhje prototipike QKD, duke përdorur kabllot me fibër optike nëndetëse për herë të parë.

Një tjetër iniciativë kërkimore e mbështetur nga SPS hetoi teknikat QKD për të dërguar çelësat kriptografikë nga një pikë fundore në tjetrën, e cila ndodhet qindra kilometra larg. Ndërkohë, studiuesit në një universitet në Republikën Çeke po studiojnë aplikimin e teknologjisë QKD në një rrjet 5G për të eksploruar potencialin e saj për të rritur sigurinë kibernetike në sistemet e ardhshme të komunikimit.

Demonstrimi i kriptografisë post-kuantike (PQC)

Ndryshe nga QKD, e cila përdor vetitë kuantike fizike për të mbrojtur informacionin, PQC përdor kriptografinë dhe funksionet matematikore si një qasje alternative për komunikime të sigurta. Një grup ndërkombëtar shkencëtarësh i mbështetur nga SPS kohët e fundit demonstroi se, duke përdorur PQC, është e mundur të transmetohet në mënyrë të sigurt informacioni pa mundësinë e deshifrimin nga një haker, qoftë edhe ai që ka një kompjuter kuantik. Përmes një protokollit të sigurt, pesë grupe kërkimore me bazë në Maltë, Sllovaki, Spanjë, Shtetet e Bashkuara dhe selinë e NATO-s në Bruksel, Belgjikë, arritën të komunikojnë në një hapësirë plotësisht të sigurt, pa rrezikun e ndërhyrjes.

Koncepti i ri Strategjik i NATO-s, i rënë dakord nga aleatët në Samitin e Madridit 2022, njeh rolin kritik të teknologjisë, dhe në veçanti, teknologjive në zhvillim dhe përçarës (EDT), në formësimin e së ardhmes së Aleancës. Për të eksploruar potencialin dhe rreziqet që lidhen me EDT-të, Programi SPS po mbështet aktivitetet kërkimore që trajtojnë tendencat teknologjike në EDT, si inteligjenca artificiale, autonomia, bioinxhinieria dhe veçanërisht teknologjitë kuantike. Aktivitetet e ardhshme të SPS që hetojnë kuantumin do të shikojnë se si të integrohen QKD dhe PQC për të siguruar infrastrukturën e informacionit në mënyrë më të mirë dhe më tërësore për Aleancën.

Dialog dhe bashkëpunim me partnerët e rinj dhe ekzistues në Indo-Paqësor

Aleanca pranon misionin e Republikës së Koresë në NATO

Këshilli i Atlantikut të Veriut ra dakord, më 26 shtator 2022, të pranohet kërkesën e Republikës së Koresë për të caktuar Ambasadën e saj në Belgjikë si Mision të Vëdit në NATO. Ky është një hap i rëndësishëm në partneritetin e fortë të NATO-s me Republikën e Koresë.

Në Konceptin e ri Strategjik të NATO-s, aleatët ranë dakord të forcojnë dialogun dhe bashkëpunimin me partnerët e rinj dhe ekzistues në Indo-Paqësor për të trajtuar sfidat ndër-rajonale dhe interesat e përbashkëta të sigurisë.

Republika e Koresë është një partner aktiv i

NATO-s. Që nga viti 2005, Aleanca dhe Seuli kanë zhvilluar një partneritet të fortë, bazuar në vlerat e përbashkëta. Dialogu politik dhe bashkëpunimi praktik po zhvillohen në fusha duke përfshirë mospërhapjen, mbrojtjen kibernetike, kundër-terrorizmin, projektet e shkencës civile të lidhura me sigurinë, ndërveprueshmërinë, mbrojtjen kimike, biologjike, radiologjike dhe bërthamore (CBRN), si dhe gatishmërinë civile, qëndrueshmërinë dhe lehtësimin e fatkeqësive.

Aleatët ranë dakord të ftojnë të gjithë partnerët e NATO-s për të krijuar misione në NATO në 2011.

DISA REFLEKTIVE TË DITËS PËR KIBERNETIKËN, KONCEPTI STRATEGJIK I NATO-S, MADRID 2022

Mbrojtja kibernetike, pjesë e detyrës kryesore të mbrojtjes së vendit dhe mbrojtjes kolektive



N/KOL (R) MSC. KANAN HIMAJ
Në Institutin e Kërkimeve
Shkencës Ushtarake

Në vëmendjen dhe në fokusin e punës, në ditët e sotme dhe jo vetëm, nga shtetarët janë kërcënimet kibernetike për sigurinë të cilat janë komplekse, shkatërruese dhe po bëhen gjithnjë e më të shpeshta. Lufta kibernetike në të gjitha fushat është bërë serioze, që tregon se kjo luftë mbetet shqetësuese edhe për të ardhmen në vendin tonë, për sigurinë dhe mbrojtjen e vendit. Në këtë kuadër, si vend anëtar i NATO-s do të vazhdojmë të jemi të ekspozuar me peizazhin në zhvillim të kërcënimit kibernetik. NATO dhe aleatët e saj mbështeten në mbrojtjen kibernetike për të përbushur detyrat kryesore për mbrojtjen kolektive, menaxhimin e krizave dhe sigurinë bashkëpunuese. Koncepti Strategjik i NATO-s 2022 thekson se ndasitë, përçarjet dhe shkatërrimi po shihet si rreziku, sfida dhe kërcënim me të cilin Aleanca duhet të përballlet përmes një mbrojtjeje, parandalimi dhe angazhimi. Ajo do t'i përshtatet më tej karakterit dhe sjelljes së luftës që ndryshon me shpejtësi, e cila tani shtrihet në një mozaik të luftës së informacionit, luftës kibernetike, luftës "konvencionale" gjithnjë e më e shpejtë (e njohur edhe si hiperluftë, tej/mbi/energji, etj.) dhe luftës bërthamore. Mbrojtja kibernetike është pjesë e detyrës kryesore të NATO-s për mbrojtjen kolektive.

Në tërësi të konceptit të mbrojtjes së vendit tonë ne duhet të vlerësojmë dhe të besojmë se Aleanca do të luftojë ndaj veprimtarive armiqësore të informacionit, përdorimit keqdashës i teknologjive të sofistikuara, spiunazhit dhe sulmeve të synuara, të cilat të gjitha kanë për qëllim minimin e besimit në liderhipin, legjitim për sigurinë dhe mbrojtjen. Në këto situata ne duhet të dallojmë dhe zhvillojmë mjete të ndjeshme për të përballuar konfliktin e "zonës gri" midis paqes dhe luftës, pra atë çka kemi provuar këtë periudhë. Qëllimi kryesor i konfliktit të "zonës gri" është të shfrytëzojë tensionet politike midis aleatëve dhe tensionet sociale brenda vendit si dhe të përdorin një sërë instrumentesh luftarake ekonomike, politike dhe informacioni, të tilla si kërcënimet ndaj furnizimeve me energji, sulmet kibernetike ndaj infrastrukturës dhe sistemeve kritike, propaganda ndaj segmenteve të shoqërisë, lufta për përmbysje politike dhe kërcënim i fuqisë ushtarake, si pjesë e grupit të shtrëngimit strategjik.

Për të përforcuar detyrat kryesore të sigurisë dhe mbrojtjes së vendit, në fokus është qëndrueshmëria e tyre. Duke vendosur angazhimin tonë dhe kërkesat bazë ripojmë qëndrueshmërinë e mbrojtjes kombëtare dhe kolektive si element jetik i parandalimit dhe mbrojtjes së besueshme, përbushjes së detyrave thelbësore. Sulmet kibernetike dhe lufta e informacionit mbi infrastrukturën kritike civile dhe ushtarake, sot konsiderohen si rreziqe të qarta dhe të pranishme. Një bashkëpunim i tillë do të ndihmojë në sigurinë, pavarësisht nga natyra dhe shkalla e një sulmi ose ngjarjeve të tjera, vazhdimësia e qeverisjes, shërbimet thelbësore për popullsinë, mbështetja do të ruhen në të gjitha rrethanat, duke forcuar kështu më tej parandalimin.

Aleanca duhet të përgatitet për të mbrojtur rrjetet dhe



operacionet e saj kundër sofistikut në rritje të kërcënimeve kibernetike me të cilat përballlet. Ruajtja e avantazhit teknologjik të Aleancës do të jetë jetike, masat të cilat po vihen në jetë edhe në strukturat tona të mbrojtjes për inovacionin e mbrojtjes janë hapa të rëndësishëm përpara në përbushjen e sfidës dhe mundësinë e teknologjive. Një nga prioritetet strategjike të Aleancës është të arrijnë qëllime, të tilla si inteligjenca artificiale, raketat hipersonike, sistemet autonome të dronëve, kompjuteri kuantik, robotika, analitika e të dhënave të mëdha, nanoteknologjitë, bioteknologjitë dhe bioinxhinieria. NATO do të veprojë si një institucion koordinues për shkëmbimin e informacionit dhe bashkëpunimin midis aleatëve dhe konkretisht me vendin tonë. Brenda këtij koncepti është edhe përshpejtimi i masave për edukimin ushtarak për aftësitë kibernetike, duke përfshirë edukimin, trajnimin dhe ushtrimet.

Aleanca do të kryejë një vlerësim të përbashkët të sistemeve të nevojshme për të përgatitur edhe asetet kombëtare jo ushtarake kritike për misionin për një fushë të gjerë të paparashikuara, siç janë sulmet ndaj infrastrukturave kritike kombëtare, sulmet kibernetike dhe kërcënime të tjera. Në këtë periudhë kërkohet më shumë vëmendje për të drejtuar procesin për të forcuar ndërlidhjen midis planifikuesve të mbrojtjes dhe komunitetit më të gjerë teknologjik duke inkurajuar partnerët industrialë të mbrojtjes që të marrin në konsideratë më tej aplikimet novatore të teknologjive me përdorim të dyfishitë, si dhe partneritetet e reja shumëkombëshe.

Në konceptin strategjik të NATO-S theksohet se është jetike për NATO-n të ruajë avantazhin teknologjik dhe ta rifitojë atë aty ku e ka humbur. Prandaj, aleatët europianë do të sigurojnë që industria e mbrojtjes të bëhet më inovative dhe konkurruese, partner i fortë për bashkëpunimin transatlantik. Koncepti Strategjik 2022 presupozon disa partneritete të reja, me një fokus të veçantë në zhvillimin dhe aplikimin e teknologjive. Ata do të rrisin shpenzimet bashkëpunuese dhe angazhohen gjithashtu të dyfishojnë investimet kombëtare dhe kolektive deri në vitin 2030.

Aleatët në një mjedis të vështirë sigurie do të vazhdojnë të sigurojnë koherencë më të madhe midis komponentëve konvencionalë, të parandalimit dhe mbrojtjes; të marrin në konsideratë rolin dhe dobinë e teknologjive të tjera në qëndrimin parandalues, të tilla si sulmet kibernetike dhe mbrojtëse; forcimi i komunikimeve strategjike efektive;

dhe të rrisë efektivitetin e stërvitjeve aleate për të ruajtur dhe demonstruar vazhdimisht përkushtimin e qëndrueshëm të NATO-s për parandalim të besueshëm.

Së fundi, Politika Gjithëpërfshirëse e Mbrojtjes Kibernetike pranon se në rrethana të caktuara ndikimi i aktiviteteve të rëndësishme të akumuluar keqdashëse kibernetike mund të konsiderohet si një sulm i armatosur. Çdo vendim se kur një sulm kibernetik konsiderohet mjaft i rëndë për të garantuar thirrjen e Nenit 5 merret nga Këshilli i Atlantikut të Veriut rast pas rasti.

Kërcënimet kibernetike sfidojnë kufijtë shtetërorë, NATO angazhohet me një numër vendesh partnere dhe organizata të tjera ndërkombëtare për të rritur sigurinë e përbashkët. Kjo mbetet qëllimi dhe deviza e së ardhmes në kuadrin e bashkëpunimit tonë me aleancën. Angazhimi bazohet në vlerat e përbashkëta dhe qasjet e përbashkëta për mbrojtjen kibernetike, mbrojtja kibernetike është një nga fushat e bashkëpunimit të forcuar midis NATO-s dhe BE-së, si pjesë e përpjekjeve gjithnjë e më të koordinuara të dy organizatave për të luftuar kërcënimet hibride.

Ne besojmë se koncepti i Aleancës të Strategjia e Inteligjencës Artificiale ka katër synime: të vendosë një bazë për zhvillimin dhe përdorimin e AI për mbrojtjen dhe sigurinë, për të përshpejtuar dhe futur në rrjedhën kryesore të adoptimit të AI në zhvillimin e aftësive, për të adresuar konsideratat e politikës së sigurisë të lidhura me AI, dhe për t'u mbrojtur kundër kërcënimeve nga përdorimi me qëllim të keq të AI. Tashmë ka ardhur koha që planifikuesit e mbrojtjes të mbajnë në konsideratë të gjitha aplikacionet e AI që do të zhvillohen dhe përdoren në përputhje me ligjin kombëtar dhe ndërkombëtar, duke përfshirë të drejtën ndërkombëtare humanitare dhe ligjin për të drejtat e njeriut.

Në institucionet shkencore të vendit po punohet me intensitetin e duhur për të rritur hapësirat e nevojshme intelektuale për të përmirësuar dhe për të forcuar elementët e domosdoshëm të ekonomisë, mbrojtjes dhe sigurisë së vendit. Tashmë mbetet parësore rritja e angazhimeve për mbrojtjen dhe bashkëpunimin përtej kufijve shtetërorë, pasi lufta kibernetike nuk njihet kufij por ajo është luftë e vërtetë që vret dhe dëmton seriozisht jetë njerëzore dhe dëmton rëndë shtetin e shoqërinë.

Lumturia e vërtetë gjendet edhe në trupat "e thyer"

ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Shumica e njerëzve e konsiderojnë një njeri me aftësi të kufizuara si të paaftë për të përballuar jetën, duke e lidhur çdo aktivitet njerëzor me aftësinë e kufizuar.

Punëdhënësit, që zakonisht janë persona pa aftësi të kufizuara, kanë vështirësi të punësojnë persona me aftësi të kufizuara, pasi nuk kanë besim në aftësitë e tyre. Shpesh ata i diskriminojnë haptazi dhe madje i përcjellin me keqardhje te porta, duke u premtuar punë për një herë tjetër. Ata paragjykojnë, pa u dhënë shansin të shfaqin cilësitë e tjera mendore e fizike që mund të kenë. Edhe media ka ndikimin e saj. Shpesh në historitë personale ose të familjeve të personave me aftësi të kufizuara, media nuk nxjerr në pah jetën e tyre normale, por thekson aspektin e të qenit "ndryshe". Madje është traditë që edhe personazhet negative në filma shfaqen me një problem fizik. Ose në rastet kur janë personazhe pozitivë, janë të mëshiruar nga të tjerët për shkak të aftësisë së kufizuar. Edhe në jetën e përditshme shumë prej nesh, kur tregojmë një histori rreth një personi me aftësi të kufizuara, theksojmë problemet e këtij personi në përballimin e jetës, vështirësitë që ai has në jetën e përditshme, duke filluar nga ngjitja e zbritja e shkallëve, ndjekja e shkollës, gjetja e një pune, vështirësitë për të krijuar një lidhje dashurore etj.

Ndodh jo rrallë që këta persona njihen në ambiente publike pikërisht me emrin e sëmundjes së tyre. Pa dashje edhe familjarët e tyre ndihmojnë në forcimin e bindjes se ata nuk dinë të bëjnë asgjë, përveçse të rrinë ulur në karrige me rrota ose në shtrat. Madje nuk mungojnë rastet kur familjarët, të lodhur e të privuar në një farë mënyre në lirinë e tyre, të abuzojnë me gjendjen shëndetësore të të afërmit të tyre, përmes injorimit, neglizhimit, dhunimit, poshtëritimit etj.

Prej këtyre diskriminimeve të hapura, ata janë të prirur të vuajnë edhe nga ana psikologjike. Shumë prej tyre mund të kenë shenja depresioni, vetëvlerësim të ulët, tipare të çrregullimeve të të ngrënit, ankth, stres etj.

Këta njerëz nuk vuajnë për shkak të aftësisë së tyre të kufizuar, por për trajtimin që u bën shteti dhe shoqëria. Në të dy rastet ka paragjykimet dhe diskriminime, që çojnë drejt përjashtimeve nga të mirat materiale, konkurrenca, socializimi, përfshirjes së drejtpërdrejtë në vendimmarrje. Shoqëria i ushqen me mungesë besimi për të ardhmen. Personave me aftësi të kufizuara nuk u nevojitet një tjetër kufizim, por një arritje, një përkrahje për të realizuar veten. Jo pak prej tyre kanë gjetur përkrahje në Forcat e Armatosura, ku u janë ofruar vende prioritare për këtë kategori. Duke i bërë të barabartë dhe të vlerë, si kolegët e tyre. Ky është integrimi social, përfshirja në jetën normale, krijimi i kushteve dhe mundësive për të jetuar me kufizime të pakufizuar.

Vetë personat me aftësi të kufizuara nuk e shohin veten si të paaftë, dhe kanë të drejtë.

Koha ka treguar që shumë personalitete botërore, që kanë pasur një aftësi të kufizuar, kanë bërë shkencë, art, politikë etj.

Ata nuk do bëhen kurrë të barabartë, nëse nuk i ndihmojmë të kenë dinjitet njerëzor integral dhe trajtim



të barabartë me të tjerët.

Karakterit i tyre nuk ka çmim dhe ata, atë duan më shumë se sa paratë dhe kujdesin pasiv, sepse janë të bindur se vetëm dinjiteti social i njeriut, është ai që e bën atë, pavarësisht nga aftësitë e munguara, të barabartë si qytetar dhe njeri me dinjitet si gjithë të tjerët.

Realitetet e vuajtjeve që kanë personat me aftësi të kufizuara duhet t'i shikojmë më gjerë, jo thjesht deri tek kujdesi social, mbështetja materiale dhe kompensimet financiare.

Tani shoqëria, familja, komuniteti, institucionet e shtetit tonë kanë detyrën e madhe, që ta observojnë më gjerë dhe humanisht realitetin e vuajtjeve që ata përjetojnë në familje dhe shoqëri. Vetëm kështu mund të zgjerohet kujdesin dhe solidaritetin social.

Si shoqëri nuk mund të ndihemi të kënaqur apo të vetëmjaftueshëm vetëm me faktin që qeveria shqiptare e ka garantuar pagesën permanente të asistencës sociale për paraplegjikët dhe tetraplegjikët, për të verbrit dhe personat me sëmundje fizike apo mendore. Asistenca sociale që jepet për personat me aftësi të kufizuara nuk është gjithçka.

Mbi të gjitha kjo masë financiare nuk mund të spostojë luftën që duhet

aftësi të kufizuar na i mësojnë:

Lumturia e vërtetë gjendet edhe në trupat "e thyer"!

Shumë thonë se më mirë të vdesin se sa të jetojnë me një paaftësi. Kjo është arsyeja se pse shumë njerëz normalë nuk mund ta imagjinojnë veten të lumtur nëse trupat e tyre do të ishin të paaftë përgjithmonë.

Me durim kalohet gjithçka!

Qysh kur je fëmijë të thuhet se sa i rëndësishëm është durimi dhe kur rritesh e kupton që kjo është shumë e vërtetë. Por ku je me aftësi të kufizuara, durimi kërkohet në një nivel krejt tjetër. Të sëmurëve i duhet të presin dhe durojnë për një kohë shumë të gjatë për të gjithë llojet e gjërave. Durimi i ndihmon emocionalisht personat me aftësi të kufizuara që të hedhin pas krahëve paaftësitë fizike.

Aksidentet mund të ndodhin, jeta të përball me të papritura!

Kur dëgjon për njerëz që mbesin të paaftë si pasojë e një aksidenti, gjithmonë mendojnë sikur të na kishte ndodhur neve – dhe e imagjinojnë si një skenë televizive ose film – diçka që mbase kurrë nuk do të na bjerë për pjesë. Por e vërteta e dhimbshme është se aksidente ndodhin çdo ditë, dhe mund t'i ndodhin të afërmeve tanë ose dikujt që ne njohim. Mundësia e këtij realiteti është e prekshme në jetën e të gjithëve.

Aftësia e kufizuar mund të prekë këdo!

Mbase kjo sëmundje nuk mund të jetë e lindur, por ndodh që një paralizë cerebrale të tjetërson jetën.

Është shokuese që papritur ta gjejsh veten në rrethin e të paaftëve ose të kesh një të tillë në familje. Por, mos harrojmë se të gjithë jemi genie me fizik jo perfekt, dhe mos të mendojmë se ne bëjmë përjashtim.

Duhet të pranojmë realitetin.

Të jesh ndryshe është një mundësi.

Shumë njerëzve nuk i pëlqen të jenë ndryshe dhe të veçohen. Një numër i madh personash nuk duan të bien në sy.

Të përshtatesh është gjëja më e mirë!

Kur je me aftësi të kufizuara, e di që kurrë nuk mund të jesh si të tjerët dhe prandaj duhet të mësohesh me këtë fakt. Të mësohesh dhe përfaqosh faktin se je ndryshe nga të tjerët mund të jetë një nga ndjenjat më bukura të të qenit i lirë. Çdokush i përket vetes, dhe ne të gjithë e dimë këtë. Dhe kjo ndjenjë është e mrekullueshme.

Nuk mund t'i gjykojë njerëzit nga pamja e tyre!

"Mos e gjykoni librin nga koperatina", Stephen Hawking, i cili mbyllti jetën e tij mbi një karrige me rrota, nuk mundi të flasë por ishte një nga njerëzit më të zgjuar në botë. Kurrë nuk mund ta dish me siguri se çfarë është i aftë të bëjë një njeri me aftësi të kufizuara.

1. NICK VUJICIC



Kur fëmijët në rrugë e pyesin se çfarë ka ngjarë më të, - ai u thotë: "Fajin e ka duhani".

2. EVGENY SMIRNOV



Nuk ka gjë më të keqe për një valltar se të humbasë aftësinë e të vallëzuarit. Por, çfarë duhet të bëjë një kërcimtar profesionist kur humbë një këmbë në aksident rrugor? Të vazhdojë të vallëzojë! Dhe këtë gjë e bëri edhe Evgeny Smirnov, kampioni rus i vallëzimit "break dance". Ai mësoi vallëzimin sërish kësaj radhe me një këmbë, ndërsa performimet e tij janë më se brilante. Ai është shembull i përkryer i madhështisë së shpirtit të njeriut.

3. OLESYA VLADYKINA



Kjo vajzë e bukur është 20-vjeçarja, Olesya Vladykina, e cila ka vuajtur shumë. Një aksident në Tajlandë ia mori jo vetëm dorën e majtë, por dhe shoqen më të mirë. Kjo fatkeqësi ndryshoi jetën e saj përgjithmonë, por, ajo nuk u dorëzua. Pas aksidentit, Olesya mori dy herë pjesë në lojërat Para-olimpike, duke fituar vendin e parë dhe duke vendosur një rekord botëror. Madje, Olesya ka refuzuar të vendosë protezën sepse, sipas saj, është shumë e përhumbshme ndërsa ajo është mësuar të kryejë punët vetëm me një dorë.

4. ANDREA BOCELLI



Verbëria nuk u mundëson njerëzve vetëm të mos shohin botën por dhe ta ndiejnë atë. Ndoshta kjo gjë e ka ndihmuar italianit Andrea Bocelli, këngëtarin e famshëm të muzikës klasike që nëpërmjet këngës, të ndajë energjinë e pabesueshme të tij me publikun. Bocelli është baba i tre fëmijëve. Bocelli kënaqet me jetën e tij sepse, siç është shprehur: edhe pse i privuar nga mundësia që ta shohë botën, unë e ndiej atë me zemrën e time.

5. SYLVESTER STALLONE



Nëse mendoni se duhet të posedoni bukuri të jashtëzakonshme që të bëheni aktor gaboheni shumë. Sylvester Stallone aktori që me rolet e tij ka bërë të dashurohen me mijëra adhurues, ka kaluar një traumë të lindur, ku pjesa e poshtme e fytyrës së tij është e paralizuar, ndërsa goja e tij paksa e shtrembër, madje dhe një pjesë e gjuhës së tij është e paralizuar, gjë që është vërejtur gjatë të folurit të tij në filma. A e ndalën këto probleme Sylvester Stallonen që të bëhet një prej aktorëve më të mëdhenj të ditëve të sotme? Qeniet humane janë krijesa që nuk janë dorëzuar para vështirësive në të cilat i ka sjellë jeta, madje në momentet më të vështira të jetës, me vullnetin e pashoq, janë shndërruar në njerëz të suksesshëm dhe inspirim për mijëra e miliona njerëz të tjerë në botë. Të gjithë jemi të ndryshëm, por ndajmë të njëjtin shpirt njerëzor. Ndoshta është natyra njerëzore që na bën të përshtatemi dhe mbijetojmë.



KOMISIONI EUROPIAN MERR PJESË NË INAUGURIMIN E TUBACIONIT BALTIK

Kadri Simson: Tubacioni do të luajë një rol të vlefshëm në zbutjen e krizës aktuale të energjisë

Komisioni përshëndeti sot inaugurimin e tubacionit Baltik, në ceremoninë e hapjes së këtij gazsjellësi të ri në Goleniów, Poloni. Ndërsa BE-ja shton përpjekjet e saj për të rritur sigurinë e furnizimit me energji, kjo infrastrukturë e re do të rrisë diversifikimin e importeve të gazit në Europën Qendrore-Lindore dhe në shtetet baltike duke hapur një rrugë të re nga Deti i Veriut në BE. Komisioneri për Energjinë, Kadri Simson, tha: “Tubacioni Baltik është një projekt kyç për sigurinë e furnizimit të rajonit dhe rezultat i një përpjekjeje të politikës së BE-së për të diversifikuar burimet e gazit. Tubacioni do të luajë një rol të vlefshëm në zbutjen e krizës aktuale të energjisë”. Komisioni e ka mbështetur prej kohësh këtë projekt politikisht dhe financiarisht si pjesë e punës së tij për të përmirësuar infrastrukturën energjetike të BE-së sipas Rregullores TEN-E. Tubacioni Baltik ka qenë një projekt me interes të përbashkët që nga viti 2013 dhe ka marrë rreth 267 milionë euro fonde të BE-së nëpërmjet Lidhjes së Europës Facility (CEF), duke ndihmuar në përfundimin e studimeve përgatitore (rreth 51 milionë euro) dhe punimeve të ndërtimit (rreth 215 milionë euro). Ai do të mundësojë importin deri në 10 bcm (bilion metër kub) në vit gaz nga Norvegjia në Poloni përmes Danimarkës dhe transmetimin e 3 bcm në vit gaz nga Polonia në Danimarkë. Fillimi i transmetimit të gazit është planifikuar për 1 tetor 2022.



Veprimi ndaj Klimës: Emetimet e CO2 nga makinat e reja ranë në 2020 pasi shitjet e automjeteve me emetim zero dhe të ulët u trefishuan

Të dhënat përfundimtare të monitorimit, të publikuara dje nga Agjencia Europiane e Mjedisit, konfirmojnë se emetimet mesatare të CO2 të makinave të reja të regjistruara në BE, Islandë, Norvegji dhe Mbretërinë e Bashkuar në vitin 2020 u ulën me 12% krahasuar me nivelet e vitit 2019. Kjo është deri tani ulja më e madhe vjetore e emetimeve që nga fillimi i zbatimit të standardeve të CO2 në vitin 2010 dhe përkon me fazën e futjes së standardeve më të rrepta të emetimeve të CO2 në të gjithë flotën e BE-së për makinat që nga 1 janari 2020. Për periudhën 2020-2024, Rregullorja përcakton objektivat e emetimit të CO2 në të gjithë flotën e BE-së në 95 g CO2/km për makinat e regjistruara rishtazi dhe në 147 g CO2/km për furgonët e sapo regjistruar, duke i dhënë një nxitje të fortë prodhuesve për të prodhuar automjete më të pastra. Rritja e përqindjes së regjistrimeve të automjeteve elektrike ishte një faktor kryesor, me shitjet e trefishuara nga 3.5% në 2019 në 11.6% në 2020. Masat e synuara të rikuperimit të vendosura nga Shtetet Anëtare stimu-

luan gjithashtu marrjen e automjeteve me emetim zero dhe të ulët dhe investime në rimbushjen e infrastrukturës. Pavarësisht kurrjes së tregut të përgjithshëm për makinat e reja në vitin 2020 për shkak të COVID-19, numri i përgjithshëm i makinave të reja elektrike u rrit, duke arritur në mbi 1 milion për herë të parë. Të dhënat përfundimtare tregojnë se legjislacioni europian për standardet e emetimeve të CO2 vazhdon të jetë një mjet efektiv për reduktimin e emetimeve të CO2 nga makinat dhe furgonat. Shumica e prodhuesve respektojnë objektivat e tyre të emetimeve, por të dhënat përfundimtare të sotme konfirmojnë se mbi 500 milionë euro do të mblidhen nga prodhuesit që kanë tejkaluar objektivin e tyre të emetimeve në vitin 2020. Një rishikim i mëtejshëm i standardeve të emetimeve të CO2 për t'i përafëruar ato me ambicet më të larta klimatike të BE-së është pjesë e Përshtatjes së Komisionit për 55 propozime të paraqitura në korrik 2021.



Strategjia “nga Ferma në Pirun”: Shtetet Anëtare miratojnë propozimin e Komisionit për të ulur pragun e mbetjeve të pesticideve për të mbrojtur më mirë bletët

Shtetet Anëtare mbështetën propozimin e Komisionit për të ulur kufijtë maksimalë të mbetjeve (MRL) të dy pesticideve neonikotinoide që dihet se kanë efekte të dëmshme te bletët. Vlerësimet e Agjencisë Europiane të Sigurisë Ushqimore tregojnë se clothianidin dhe thiametoxam paraqesin një rrezik të lartë për pjalmuesit. Për këtë arsye, përdorimi i tyre në natyrë ishte ndaluar tashmë në BE në vitin 2018. Për importet e ushqimeve dhe ushqimit të kafshëve, rregullat e reja do të ulin kufijtë maksimal ekzistues të mbetjeve për këto substanca në nivelin më të ulët që mund të matet me teknologjitë më të fundit. Rregullat pritet të miratohen në fillim të vitit të ardhshëm. Operatorët e biznesit të ushqimit dhe vendet e treta do të kenë kohë të mjaftueshme për t'u përshtatur me rregullat e reja. MRL-të e reja do të zbatohen për ushqimin e prodhuar në BE - për të cilin pragu është tashmë shumë i ulët - dhe për ushqimet e importuara nga vendet e treta. Komisionerja për Shëndetin dhe Sigurinë Ushqimore, Stella Kyriakides, tha: “Kjo është hera e parë që ne kemi ulur MRL-të për të marrë parasysh ndikimin e substancave aktive në mjedis që mund të kenë pasoja globale. Ky është një hap i rëndësishëm për punën tonë nën strategjinë “nga



Ferma në Pirun”. Duke pasur parasysh ndikimin e tyre negativ te pjalmuesit në mbarë botën, përfshirë bletët, përdorimi i këtyre dy neonikotinoideve tashmë është ndërprerë në BE. Ne po hedhim një hap të mëtejshëm, duke kontribuar në kalimin drejt sistemeve të qëndrueshme ushqimore, edhe në skenën globale. Pasi të jenë vendosur rregullat e miratuara sot, produktet e importuara nuk do të mund të përmbajnë më mbetje të këtyre dy neonikotinoideve. Rregullorja do të zbatojë objektivat e Komisionit, të shpallura në Marrëveshjen e Gjelbër Europiane dhe Strategjinë “Farm to Fork”, dhe do të marrë parasysh aspektet mjedisore kur

vlerësohen aplikimet për tolerancat e importit për pesticidet që nuk janë më të autorizuar në BE, duke respektuar standardet dhe detyrimet e Organizatës Botërore të Tregtisë (OBT). Pas konsultimit me anëtarët e OBT-së, propozimi i Komisionit iu dorëzua Komitetit të Përhershëm për Bimët, Kafshët dhe Ushqimin, ku mori mbështetjen e shumicës së cilësuar të Shteteve Anëtare. Rregullorja do t'i kalojë Këshillit dhe Parlamentit, të cilët kanë dy muaj kohë për të reaguar. Nëse të dy institucionet nuk kundërshtojnë, rregullorja do të miratohet në fillim të vitit 2023.

“Avionë të Gjelbër”: Anëtarë nga industria aeronautike dhe më gjerë regjistrohen në Aleancën për Aviacionin me Zero Emetime

Komisioni Europian publikon listën e anëtarëve fillestarë të Aleancës për Aviacionin me Zero Emisione (AZE), e cila përfshin kompani të të gjitha madhësive nga i gjithë ekosistemi industrial i transportit ajror, duke përfshirë industrinë aeronautike, linjat ajrore, qiradhënësit e avionëve, aeroportet, ofruesit e energjisë, shoqatat e biznesit dhe organizatat e shoqërisë civile. Agjencia e Sigurisë së Aviacionit të Bashkimit Europian (EASA) dhe Eurocontrol, organizata europiane e menaxhimit të trafikut ajror, i janë bashkuar gjithashtu Aleancës. Nisur nga Komisioneri për Tregun e Brendshëm Thierry Breton, në qershor 2022, anëtarët e AZEA angazhohen të përgatiten për aviacionin me emetim zero përmes, për shembull, avionëve me hidrogjen dhe elektrikë. Përfaqësimi i gjerë i aktorëve nga i gjithë ekosistemi i transportit ajror vërteton nocionin thelbësor të Aleancës se përfitimet e avionëve me emetim zero mund të realizohen vetëm nëpërmjet një përpjekjeje të përbashkët nga të gjitha palët e interesuara. Aleanca synon të trajtojë disa aspekte që lidhen me kërkesat për karburant dhe infrastrukturën e hidrogjenit dhe avionëve elektrikë në aeroporte, burimin e karburanteve të rinovueshme dhe energjisë elektrike, standardizimin dhe certifikimin, praktikën për operatorët e linjave ajrore dhe menaxhimin e trafikut ajror. Me një total prej 74 anëtarësh që u bashkuan në këtë valë të parë nga BE dhe më gjerë, Aleanca ka një bazë të fortë për të nxjerrë një plan për avionët me hidrogjen dhe elektrikë. Si hap tjetër, AZEA do të mbajë takimin e parë të Asamblesë së Përgjithshme më 14 nëntor 2022 në Bruksel. Aleanca vazhdon të jetë e hapur për çdo palë të interesuar që dëshiron të bëhet anëtare.

Inteligjenca artificiale mund t'i tejkalojë njerëzit në shumicën e profesioneve

Në vitin 2050, inteligjenca artificiale mund të tejkalojë njerëzit në shumicën e profesioneve.

Softueri i Inteligjencës Artificiale mund t'i tejkalojë njerëzit në punët me jakë të bardhë që përfshijnë ndërtimin e raporteve të kompanive, hulumtimin e tregut dhe shumicën e funksioneve administrative. Në disa skenarë, ata gjithashtu mund të shkruajnë skenarë, të bëjnë muzikë, të shkruajnë romane dhe më shumë.

Robotët e inteligjencës artificiale mund të tejkalojnë njerëzit në punë të tilla si rojet e sigurisë, kamerierët, kuzhinierët dhe mbledhësit e depove.

Shumë kompani madje do të kenë zëvendësuar shumicën e departamenteve të tyre të burimeve njerëzore me AI. Në këto kompani, inteligjenca artificiale do të merret me rekrutimin, intervistat e punës në raundin e parë, orientimet e punonjësve, vlerësimet e performancës dhe vendosjen se kush të pushojë. Si një prej këtyre, disa korporata madje do të përdorin inteligjencën artificiale për të pushuar punonjësit në mjediset e Metaverse- duke hequr pothuajse tërësisht elementin njerëzor nga këto situata që ndryshojnë jetën.

Departamentet e tjera brenda kompanive si financa, juridiku, shitjet, marketingu dhe shërbimi ndaj klientit gjithashtu do të kenë ndryshuar përgjithmonë.

Gjysma e vendeve të punës aktuale në botë nuk ka gjasa të ekzistojnë në vitin 2050

Bota po ndryshon më shpejt nga sa mendojmë dhe mënyra se si i mësojmë gjërat dhe ajo që mësojmë duhet të ndryshohet. Punëdhënësit duhet të krijojnë një kulturë angazhuese të të mësuarit në punë duke fuqizuar stafin e tyre për të marrë pronësinë e zhvillimit të tyre profesional.

BE-ja do të përballet me mungesë punonjësish të IT-së

Ka një kërkesë të madhe për zhvillues në Europë, megjithatë shumica e arsimit për IT ofrohet vetëm në anglisht. Me 24 gjuhë zyrtare që fliten vetëm në Europë, nuk është për t'u habitur që anglisht-folësit jo amtarë preferojnë të mësojnë në gjuhën e tyre. Sidoqoftë, mund të filloni të shihni shumë akademi, shkolla dhe universitete kodimi të fokusuar vetëm në trajnimin e zhvilluesve të rinj për kërkesat e kompanive specifike, duke qenë se është një gjuhë, një praktikë, etj. Edhe pse ky problem nuk do të zgjidhet tani, me këto IT të shtuar, me universitetet dhe akademitë, ne mund ta rregullojmë situatën deri në vitin 2050.

Sytë bionikë

Në vitin 2050, retina artificiale dhe proteza të tjera vizuale mund të përputhen me cilësinë vizuale të një syri të vërtetë njerëzor. Ato do të përmbajnë grupe elektrodash me qindra megapiksel me ngjyra të plota së bashku me aftësitë me valë. Ky do të jetë një hap thelbësor në krahasim me pajisjet në dekadat e mëparshme që ofronin pamje bardh e zi.

Disa versione të këtyre implanteve jo vetëm që do të ofrojnë një kurë për verbërinë për shumë njerëz, por ato gjithashtu do të përmbajnë përmirësime të mëtejshme. Këto përmirësime do të përfshijnë kamerat e integruara, WiFi, realitetin e shtuar, shikimin e natës, vizionin termik, aftësinë e zmadhimit, etj. Kur dikush do të përdorë këto pajisje, do të jetë e mundur të komunikosh me valë me ta duke përdorur tekstin e mbivendosur në vizionin e tyre.

Këto pajisje të përmirësuar do të jenë praktikë standarde midis organizatave spiune, ushtarakëve dhe qytetarëve të profilit të lartë. Sidoqoftë, ato do të bëhen mjaft të lira edhe për publikun e zakonshëm.

Dobësitë kryesore janë shqetësimet e privatësisë dhe sigurisë. Disa burime qeveritare dhe korporative tregojnë se këto pajisje mund të ekspozojnë potencialisht një numër të madh skandalesh qeveritare dhe korporative.

Terapitë gjenetike do të minimizojnë sëmundjet e rënda

Teknologjitë dhe qasjet si: CRISPR; Terapitë gjenetike; Organet dhe enët e gjakut të printuara 3D; Nanogramca; Nanorobotika, do të minimizojnë dhe kurojnë sëmundjet e rënda në mënyra që ishin të pamendueshme më parë.

Shkalla e mbijetesës 5-vjeçare do të ketë arritur afër 100% për forma të caktuara të kancerit duke përfshirë kancerin e zorrës së trashë.

Sëmundjet të tjera që do të zbuten në mënyrë të konsiderueshme janë: SIDA, Ebola, verbëria, anemia drapërqelizore, sëmundjet e zemrës dhe më shumë.

Kostoja e energjisë do të jetë tepër e lirë

Nga fillimi i viteve 2040, pjesa më e madhe e botës së zhvilluar dhe disa vendeve në zhvillim do të furnizohen kryesisht nga dielli dhe era.

Një arsye kryesore për kostot më të ulëta të energjisë do të jetë përdorimi në rritje i energjisë së tepërt të gjeneruar nga panelet diellore dhe turbinat e erës që përndryshe do të ishin tretur. Kjo energji e tepërt do të ruhet dhe ridrejtohet për t'u përdorur për aplikime jo të ndjeshme ndaj kohës, si karikimi i baterive të makinave të parkuara, heqja e kripës nga uji i kripur, riciklimi i mbeturinave dhe rafinimi i metaleve. Jo vetëm që kostot e energjisë do të bien, por edhe kostot për çdo gjë që mbështetet në atë energji do të ulen, që përfshin koston e ujit, materialeve, prodhimit dhe llogaritjes.

Super rrjetet në mbarë kontinentin gjithashtu do të të shfaqen. Këto super rrjete do t'u lejojnë kombeve të ndajnë tepriçën e energjisë së pastër nga burime të bollshme dhe ta shpërndajnë atë



në rajonet më në nevojë. Duke bashkëpunuar në këtë mënyrë, do të bëhet e mundur të reduktohen në masë të madhe mbeturinat dhe të optimizohen furnizimet me energji elektrike në një shkallë të gjerë në kontinent, në çdo kohë të vitit.

Një tjetër pozitive për të gjithë këtë është se përdorimi i burimeve të energjisë së pastër do të eliminojë më shumë se 50 për qind të të gjitha emetimeve të gazrave serrë, që është deri tani faktori më i madh i ndryshimeve klimatike.

Energjia Termike e Oqeanit mund të na çojë në 100% energji të rinovueshme

Energjia termike e oqeanit, është një burim kryesisht i pashfrytëzuar dhe një nga burimet më të mëdha të energjisë së rinovueshme në botë. Për shembull, tani "Bluerise" po punon në krijimin e një përparimi energjetik duke gjeneruar energji elektrike në shkallë të shërbimeve përmes konvertimit të energjisë termike të oqeanit. Ai do të jetë në gjendje të tejkalojë prodhimin e bazuar në lëndë djegëse fosile dhe burimet e tjera të rinovueshme që kërkojnë ruajtje dhe balancim të rrjetit. Ai do të luajë një rol vendimtar në përzjerjen e ardhshme të energjisë, duke qenë një nga burimet e pakta të energjisë konstante, i disponueshëm ditën dhe natën, gjatë gjithë vitit.

Shumica e transaksioneve dixhitale do të përdorin teknologjinë Blockchain

Një blockchain është një bazë të dhënash e përbashkët që u lejon palëve të shumta të aksesojnë të dhënat dhe t'i verifikojnë ato të dhëna në kohë reale. Që nga fundi i viteve 2030, shumica e transaksioneve dixhitale të të gjitha llojeve do të jenë në një blockchain. Teknologjia Blockchain do të jetë bërë një themel për shoqërinë pothuajse po aq sa energjia elektrike, interneti dhe inteligjenca artificiale.

Kriptovalutat bazohen në teknologjinë blockchain. Në vitin 2050, një person mesatar do të përdorë kriptovalutat në baza normale për shkak të lehtësisë së përdorimit të tyre, rritjes së sigurisë dhe mbrojtjes kundër inflacionit.

Transferimet e të dhënave midis Tokës dhe Marsit do të kryhen kryesisht duke përdorur teknologjinë blockchain. Investitorët në Tokë mund të fitojnë pronësinë e pjesshme të një objekti të prodhimit të ujit në Mars. Dhe përmbajtja dhe aplikacionet e krijuara në Mars do të jenë në gjendje të bëhen virale në Tokë. Do të duhen vetëm 5 deri në 20 minuta që të dhënat të transmetohen midis Marsit dhe Tokës, në varësi të pozicioneve të tyre planetare rreth diellit.

Teknologjia Blockchain do të ndihmojë për të luftuar falsifikimet e thella. Kjo për shkak se çdo pajisje me një aparat fotografik do të të fitojë opsionin për të vërtetuar fotot dhe videot dhe për t'i vendosur ato në blockchain. Për shkak të kësaj, çdo foto ose video e ngarkuar në një burim të besuar uebsajti duhet të tregojë vërtetimin e saj të bllokut.

Nanobotët do të futin trurin tonë direkt në cloud

Teknologjia e së ardhmes: nanobotët. Ai beson se deri në vitin 2050, nanobotët do të futin trurin tonë drejt e në cloud, do të na japin një zhytje të plotë të realitetit virtual nga brenda sistemit nervor. Ashtu siç bëjmë me telefonat tanë inteligjentë, ne do të jemi në gjendje ta bëjmë atë me trurin tonë, ne do të jemi në gjendje të zgjerojmë neokorteksin tonë në cloud. Dhe harroni problemet e kujtesës, problemet e provave, etj.

Rimishërimi i njerëzve përmes AI

Tingëllon e frikshme, e di! Dhe ndoshta shumica e njerëzve fetarë do të jenë shumë kundër saj, megjithatë, Kurzweil thotë se ne do të jemi në gjendje t'i "rikthejmë" të afërmit tanë përmes Inteligjencës Artificiale.

Deri në vitin 2050, ne do të jemi në gjendje të dërgojmë nanobotë në trurin e njerëzve për të nxjerrë kujtimet e njerëzve të dashur. Me një mostër të ADN-së të të ndjerit do të jetë e mundur të krijohet një version virtual bindës i dikujt që nuk është më.

Teknologjia IoT do të ndryshojë modelet e produkteve Sipas "Forbes", deri në vitin 2050, teknologjia IoT do të jetë

në 95% të elektronikës për dizajne të reja produktesh. Dhe deri në vitin 2050 pritet që gjithçka të jetë e lidhur me cloud dhe internet.

Makinat pa pilot do ta bëjnë udhëtimin më të sigurt

Pavarësisht aksidenteve që përfshijnë makinat që drejtojnë vetë, kjo zonë e AI mund të reduktojë në mënyrë dramatike vdekjet dhe lëndimet në rrugët tona. Sipas një raporti nga Universiteti i Stanfordit, jo vetëm që makinat që drejtojnë vetë do të reduktojnë vdekjet dhe lëndimet në trafik, por ato mund të sjellin edhe ndryshime në stilin tonë të jetesës. Do të kemi më shumë kohë për veten tonë.

Gjithashtu, rehatia e shtuar dhe ulja e ngarkesës njohëse me makinat që drejtojnë vetë dhe transportin e përbashkët mund të ndikojnë në vendin ku njerëzit zgjedhin të jetojnë.

Zgjidhje me dronë për zbulimin e vendeve të paprekura

Thellë në miniera nëntokësore, disa zona janë të paarrishme. Por kompanitë si "Inkonova", e cila filloi të punojë në ndërtimin e dronëve që fluturojnë, ngasin dhe ngjiten dhe përdorin teknologjinë lazer për të skanuar zonat dhe për të krijuar një hartë 3D të tyre. Me këtë teknologji të avancuar të robotikës ajrore, ne do të jemi në gjendje të shtyjmë arrijtjen e njeriut në çdo hapësirë të paprekur nga infrastruktura e krijuar nga njeriu.

Tunelet "Hyperloop" do të mundësojnë udhëtime më të shpejta ndërkontinentale

Koncepti i "hiperloop"-it zakonisht përfshin kutitë e pasagjerëve që udhëtojnë nëpër tuba nën presion duke përdorur shtytje elektrike dhe levitacion magnetik. Me këtë metodë, ngarkesat transportohen gjithashtu shumë më shpejt se më parë. "Hyperloop pods" do të udhëtojnë me shpejtësi midis 600 dhe 700 milje në orë. Ato gjithashtu do të reduktojnë emetimet e gazeve serrë të lidhura me tranzitin me 90%. Dhe për shkak të kohës që kursejnë, ato ofrojnë përfitime ekonomike që arrijnë në mbi një trilion dollarë çdo vit në krahasim me metodat e mëparshme të transportit.

Mbi një duzinë tunele të brendshme hiperloop do të jenë finalizuar në fillim të viteve 2030.

Ky zhvillim do të krijojë një bum në industrinë e turizmit, por do të pengojë gjithashtu industrinë e udhëtimeve ajrore dhe hekurudhore. Megjithatë, prezantimi i gjerë i avionëve supersonikë në fillim të viteve 2030 për udhëtime në distanca të gjata do të zbusë efektet e kësaj përçarjeje.

Luftë me Inteligjencë Artificiale

Do të jetë e mundur të bëhet një luftë e tërë duke përdorur vetëm robotë dhe automjete plotësisht autonome. Por, aftësitë do të kenë arritur një nivel të ri.

Një tufë prej dhjetë mijë dronësh do të mund të vendoset me një kosto prej 10 milionë dollarësh.

Një raketë hipersonike e kontrolluar nga AI do të mund të udhëtojë në anën tjetër të globit në dy orë dhe të manovrojë sistemet konvencionale mbrojtëse.

Robotët plotësisht autonomë me qëllim pothuajse të përsosur do të zëvendësojnë një përqindje të lartë të ushtarëve njerëz në ushtritë kryesore në mbarë botën. Asnjë njeri me armë konvencionale nuk do të kishte një shans kundër këtyre makinerive, të cilat gjithashtu do të kenë aftësinë për të shëruar veten duke përdorur nanoteknologjinë. Për misionet më delikate, këta robotë do të mund të kontrollohen edhe nga ushtarë që mbajnë kufje të realitetit virtual në vende të afërta.

Shumica e avionëve luftarakë do të jenë gjithashtu plotësisht autonome. Një kombinim i inteligjencës artificiale të fuqishme, sjelljes së grumbullimit, shpejtësisë hipersonike dhe sistemeve të njohjes pothuajse të përsosur të objektivit do të mundësojë efekte pothuajse të menjëhershme në të gjithë zonat e luftimit.

Sistemet e luftës dhe shmangies së përplasjeve të përqendruara në rrjet do t'u mundësojnë skuadroneve të avionëve autonome të sinkronizohen, të sulmojnë nga drejtime të shumta dhe të rigrupohen në sekonda.

Për shkak të kohës së tyre të reagimit çnjerëzor dhe armatimit të përmirësuar, asnjë pilot njerëzor nuk do të kishte një shans kundër këtij loji të armikut.

Ali Kastrati, sportisti universal, krenari kombëtare

Legjenda e ringut shqiptar, Ali Kastrati, do të mblidhte në 100-vjetorin e lindjes së tij, në auditoriumin e Ministrisë së Mbrojtjes, emrat elitë të sportit shqiptar, të cilët sollën në vëmendjen e brezave të rinj mjeshtrinë e madh të shumë disiplinave sportive, trajnerin, profesorin, i cili punoi me vrull djaloshtar deri në fund të jetës.

Ali Kastrati, me ngrohtësinë, kujdesin apo këshillat e tij, shpesh nga sportistët thirrej dhe 'baba Aliu'. Kështu do të flisnin në këtë 'ditëlindje' të tij, miq, kolegë dhe nxënës të tij.

Vështirë të gjendet një tjetër sportist a trajner, që të mbajë në gjoksin e tij më shumë trofe të fituara, se Ali Kastrati.

Ali Kastrati, fitues i titullit kampion në boks në vitet 1947, 1948, 1950, 1951.

Në mundje është shpallur pesë herë kampion kombëtar.


Nga 20 takime ndërkombëtare që ka zhvilluar, ka fituar shtatëmbëdhjetë ndeshje, barazuar një dhe humbur dy të tilla.

Në boks, ekipi i "Partizanit" i drejtuar prej tij, është shpallur pesëmbëdhjetë vjet kampion (1947 - 1953, 1956 - 1963).

Në mundje, ekipi i tij është shpallur tetëmbëdhjetë herë kampion.

Në peshëngritje, dymbëdhjetë rekorde dhe ekipi i tij i "Partizanit" ka fituar titullin kampion tetëmbëdhjetë herë radhazi, nga vitet 1949 - 1966.

Ekipe të drejtuara prej tij kanë fituar plot gjashtëdhjetë e pesë tituj kampion kombëtar dhe të gjitha kupat e Republikës që zhvilloheshin atëherë. Ai ka qenë për një kohë shumë të gjatë edhe trajner i ekipit tonë kombëtar. Asnjëherë sportistët që ai ka drejtuar, nuk kanë fyer kundërshtarin, nuk kanë reaguuar ndaj arbitrave apo ndaj publikut me fjalë apo gjeste të papëlqyera. Në ato vite, baza materiale mund të ishte e mangët, por Aliu i gjente mënyrat që ta plotësonte atë dhe ta bënte sa më të efektshme.



Në ring me boksierin bullgar Vladimir Kristof, 1947

tratin, shumëkush e nje dhe për mjek - masazhator të ekipeve tona në lloje të ndryshme sporti. Të gjithë e mbajnë mend mirë sesi në moshë të thyer ai vraponte duke sfiduar haptazi moshën e tij, për t'u ardhur në ndihmë sportistëve të dëmtuar në ndeshjet e ndryshme.

Është vështirë të gjesh një të dytë me arritjet dhe përkushtimin e tij në të tre disiplinat e sporteve të rënda si Ali Kastrati", - do vijonte në kujtimet e tij Bashkim Mërtiri, sekretar i Veteranëve të Boksit shqiptar.

Bejkush Birçe do të shprehej: "... mjaft të shikosh çfarë medaljesh zbulojnë gjoksin e Ali Kastratit dhe ke kuptuar punën e palodhur 70-vjeçare të Mjeshtrit të madh.

Ka drejtuar tre disiplina të ndryshme sportive dhe tek të treja ka nxjerrë vetëm kampionë, Aliu ecte me moton "nuk ka pushim në sport".

Në vitin 2003 ai u nderua nga Presi-



Ali Kastrati në verën e vitit 1944, gjatë stërvitjes, para se të dalë në ring me boksierin gjerman Hufs Jan kampion i Gjermanisë

Në emër të Shoqatës të Veteranëve të Boksit Shqiptar, Shoqatës Kombëtare të Mundjes, të Federatave shqiptare të sporteve boks, mundje, peshëngritje e futboll si dhe të shoqatave të ushtarakëve në rezervë dhe Skënderbegasve, përshëndeti z. Et'hem Ibrahim, i cili ndër të tjerë tha: "Jemi mbledhur sot për të përkujtuar një nga mjeshtrit e mëdhenj të sportit shqiptar, një sportist e trajner që njëherazi, si rrallë në historinë e sportit, ka drejtuar tre disiplina në klubin legjendar "Partizani" si dhe ekipe kombëtare të këtyre sporteve.

Ali Kastrati ka qenë dhe do të mbetet një figurë e lartë atdhetare, humanitare dhe një personalitet i shquar i sportit Shqiptar.

Si një veteran i Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare pas

përfundimit të saj për kontributin e dhënë, ai mori statusin e veteranit të LANC-it dhe së bashku me shumë shokë të tjerë që ushtroheshin me sport qëndruan në ushtri ku luajtën një rol parësor në zhvillimin e sportit në Shqipërinë e atyre viteve.

Kastrati është një nga themeluesit e KS Partizani. Mes të tjerash zoti Et'hem falënderoi për bashkëpunimin e frytshëm në realizimin e këtij aktiviteti Ministrinë e Mbrojtjes dhe QKMBMMFA".

"Ali Kastrati është një nga pionieret e sportit shqiptar, babai i sporteve të rënda. Duke qenë nismëtar i këtyre sporteve fillimisht në ushtri dhe duke e shtrirë atë në të gjithë vendin. Nga shtanga, tapeti apo ringu, ai largohej vetëm kur bindej se objektivat ishin realizuar tërësisht. Dhe sikur të mos mjaftonin të gjitha këto, Ali Kas-

denti i Republikës me titullin "Mjeshtri i Madh".

Në emër të familjes Kastrati, përshëndeti mbesa e tij, e cila mes lotësh falënderoi miqtë, shokët, bashkudhëtarët e tij, për emocionet e ditës së lindjes të mjeshtrit të madh.

Për këto asete, vlerë e krenarisë shqiptare, do të festohen veç ditëlindje, sepse pesha e historisë së tyre i ngre në piedestale, referencë për brezat e rinj.

“YJE TË PASHUAR”

Nazmi Rushiti dha jetën nga torturat fashiste



Prof. Asoc. Dr. BERNARD ZOTAJ,
(Mjeshtëri i Madh)

Nazmi Rushiti ka lindur në vitin 1919 në fshatin Koxhaxhik të Dibrës, fshat ku ndodhet kalaja e Sfetigradit. Pasi mbaroi shkollën fillore të “Kastriotit”, megjithëse doli shkëlqyeshëm, nuk i vazhdoi menjëherë mësimet, sepse familja e tij ishte e varfër. Nazmiu, për t’i ardhur në ndihmë familjes, u fut si shegert në Dibër dhe më pas punoi si kamerier në qytetin e Peshkopisë. Në vitin 1930 mori një bursë, për të vazhduar shkollën në internatin e “Kastriotit”.

Në 1933, mbaroi shkollën e “Kastriotit” dhe u dërgua në Shkollën Teknike të Tiranës, ndërsa vitin shkollor 1934-1935 e kreu në gjimnazin e Shkodrës. Ambienti i ri shoqëror i gjimnazit, leximi i librave “të ndaluar”, të cilat ia jepte fshehurazi në fashikuj shoku i tij Qemal Stafa, hapën tek Nazmi Rushiti mendime të reja, ideale të reja për të cilat ai punoi dhe luftoi deri në fund të jetës. Në vitin 1936 u bë anëtar i grupit komunist të Shkodrës me Qemal Stafën, që ishte bashkëthemelues i Grupit Komunist të Shkodrës.

Nazmiu ishte një nga veprimtarët më aktiv të grupit komunist të Shkodrës. Grupi i Shkodrës ishte një organizim para partiak komunist që u formua dhe veprroi nga koha e mesluftërave botërore dhe deri në themelimin e Partisë Komuniste në Shqipëri.

Nazmi Rushiti u bë shok me Emin Durakun, që ishte një nga anëtarët më aktivist të grupit komunist të Shkodrës, së bashku Tom Kolën e Sadik Bekteshin, i cili në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare u bë komisar i batalionit “Perlat Rexhepi” dhe më pas komandant i Br. XXVII S, e cila veprroi dhe luftoi edhe në Kosovë.

Në gjyq mbajti qëndrimi burrnor

Në Tiranë Nazmi Rushiti u zbulua nga xhandarmëria si nxënës me “ide të kuqe” dhe e transferojnë në gjimnazin e Shkodrës. Por edhe në qytetin e Shkodrës dhe në gjimnaz gjeti një lëvizje, ku ai u bë dhe një agjikator i zoti, duke propaganduar idetë komuniste dhe punoi pa u lodhur për demaskimin e regjimit të mbretit Zog. Për aktivitet antizogist, në janar 1939, arrestohet së bashku me Qemal Stafën dhe dënohet me 4 vjet burg. Me pushtimin fashist në prill 1939 del nga burgu dhe merr pjesë në demonstratat dhe protestat e studentëve dhe të popullit të Tiranës, që kërkonin armë, për të luftuar pushtimin fashist të Shqipërisë në prillin e vitit 1939.

Ndërsa, më 6 dhjetor 1939, përjashtohet nga shkolla me motivimin si “element turbullues, organizator i demonstratave antifashiste dhe komunist i rrezikshëm”.



Kur e përjashtuan nga shkolla, Nazmi Rushiti iu drejtua drejtorit të shkollës me fjalët: “Ti zotni drejtor mund të më përjashtosh nga konvikti e shkolla dhe me anë të padronëve të tu, fashistëve italianë, edhe mund të më burgosësh. Por mendimet dhe fjalët e mija as ti, as padronët e tu s’jini të zot të m’i frenoni, as të m’i ndaloni deri sa në kraharorin tim të mos ketë pushuar frymëmarrja”.

Në burgjet e fashizmit

Pushtimi i vendit nga fashizmi italian e tronditi shpirtërisht Nazmi Rushitin, por e bëri dhe më të vendosur për të vazhduar luftën e nisur. Për aktivitet antifashist u përjashtua nga gjimnazi i Shkodrës në dhjetor 1939 së bashku me shokët e tij të luftës Tom Kolën, Emin Durakun, etj., duke u cilësuar si “element turbullues, organizator i demonstratave dhe komunist i rrezikshëm”.

Kuestura italiane e arrestoi Nazmiun dhe për këtë aktivitet të gjerë, në janar 1939 arrestohet, nxirret në gjyq dhe dënohet bashkë me Qemal Stafën, së pari me internim në Mbreshtan të Beratit, pastaj në burgun e Gjirokastrës që gjendej në kalanë e Gjirokastrës, dhe prej andej

e dërgojnë në internim në kampin e Ventotenës (ishull në Itali) me motivacionin: “predikues fanatik i doktrinave ekstreme, element turbullues me pikëpamje komuniste”.

Nazmi Rushiti do t’u thoshte autoriteteve fashiste: “Ju falemindërit shumë, zoti federal që më dhatë mundësinë të vij (në internim) e ta njoh fashizmin në vendin e vet, mbasi në vendin tim e kisha njohur me kohë”.

Fillimi i luftës nga njësitet guerile

Nazmi Rushiti, në shtator 1941, u kthye nga internimi në Shqipëri, ku vazhdoi jetën revolucionare. U bë anëtar i Partisë Komuniste Shqiptare më 8 nëntor 1941. Nazmiu u dërgua në qarkun e Dibrës, ku punoi dhe dha një kontribut të madh për krijimin e organizatave të rinisë si në Peshkopi, Maqellarë, Zerqan, Gollobordë, Reç, Slllovë, në qytetin e Dibrës, etj.

Ai ishte organizatori dhe mori pjesë në aksionin e qershorit 1942, tek gurët e Skënderbeut në Bulqizë, në aksionin në përpjekje me karabinierët në malin e Kërçinit, organizoi prerjen e linjave telefonike për disa herë në të gjithë Dibrën.

Nazmi Rushiti së bashku me anëtarët e njësitit gueril të Peshkopisë Dali e Esat Ndreun, Demir Gashin, Xhavit Hatibin, Veli Devën, Ejup Hatibin, Beshir Laçin, Ilmi Çausollin e të tjerë organizuan, më 16 shtator 1942, aksionin në minierën e Bulqizës. Ata pushtuan vendbanimin e punëtorëve italianë, i mblodhën e u shpjeguan qëllimet e LANÇ-it, të disfatës përfundimtare dhe të pashmangshme që u kërcënohej fashistëve nga aksionet e njësiteve guerile. Në fund, iu bëri thirrje të linin punën në minierë dhe të ktheheshin në familjet e tyre në Itali. Ata kënduan me punëtorët këngë revolucionare antifashiste italisht dhe në realitet punëtorët italianë braktisën punën në minierë dhe u kthyen në Itali. Kështu puna për shfrytëzimin e minierës së kromit në Bulqizë pushoi së vepruari. Armët që iu dorëzuan njësitit gueril. Për këtë aksion, komanda e karabinierëve njoftoi kryeministrin, me shkresën nr. 145615, datë 17.09.1942.

Gjithashtu Nazmi Rushiti ishte në krye të aksionit në Bulqizë, të prerjes së linjave telefonike, në aksionin në Qafë-Murrë, në vrasjen e kriminelit

dhe xhelatit Stavro Jaho, etj. Këto ishin disa nga veprimtaritë e njësitit gueril të Dibrës të organizuara dhe të drejtuara me sukses nga Nazmi Rushiti.

Aksioni i fundit i heroit

Së bashku me anëtarin e njësitit gueril, Demir Gashin dhe me luftëtarë të rezistencës në zonën e Zerqanit, Nazmiu kreu aksionin kundër Stavri Jahos, komandantit të Karabinierisë italiane të nën-prefekturës së Zerqanit. Ky kishte bërë krime në Pezë, kishte torturuar anëtarë të njësiteve guerile të kapur nga fashistët dhe të dënuar në burgje, ai ishte i dënuar me vdekje nga qendra e rezistencës në Tiranë. Pas aksionit, Nazmiu i penguar nga një oficer armik, ndërroi drejtimin e tërheqjes dhe, pasi kaloi disa mure, nga hedhja pësoi tronditje dhe mbeti pa ndjenja, sepse ai vuante dhe nga zemra. Në aksionin e Zerqanit, duke humbur drejtimin, bie nga një lartësi dhe thyen këmbët. Karabinierët italianë e panë dhe e kapën para se të përmendej. E futën në burg, e torturuan në mënyra nga më çnjerëzoret, edhe pse ishte me të dy këmbët të thyera. U rezistoi torturave në karabinierinë e qarkut Peshkopi, duke mos folur asgjë për shokët e rezistencës.

Në burgun e Peshkopisë fashistët italianë i vazhduan gjatë torturat, duke e rrahur me litarë e duke ia shpuar me shtiza të nxehta trupin. Në gjendjen tepër kritike për jetën ai iu përgjigjej fashistëve italianë se “ne luftën do ta fitojmë, do ta fitojmë që kur kemi kapë armët dhe që kur kemi mësue se nga me i drejtue plumbat”.

Në mesin e natës së 27 shtatorit 1942, kur filli i jetës së tij po këputej, fashistët shkuan për t’i bërë “kurën” tjetër të torturave dhe në vend të përgjigjes së dëshiruar, dëgjuan: “Rroftë Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare!” Në këto rrethana, i pushoi zemra përgjithmonë heroit.

Nazmi Rushiti u kthye në simbol

Kështu Nazmi Rushiti u bë dëshmor i parë i LANÇ-it për Dibrën. Për veprën e tij heroike, pas vdekjes, Kuvendi Popullor i RPSH e ka shpallur “Hero të Popullit”. Populli i ka thurur mjaft këngë dhe elegji ku midis të tjerave i ka kënduar: “Nazmi Rushiti djalë me huqe, /

këmishën e zezë ta bën të kuqe”.

Për Nazmi Rushitin u ngritën buste, u shkrua dhe një monografi nga Lutfi Hanku, ndërsa Shkolla Profesionale në Peshkopi mban emrin e tij. Po në qytetin e Peshkopisë është një lagje dhe një rrugë me emrin e tij. Ndërsa një rrugë në Tiranë në njësinë administrative nr. 2 mban emrin Nazmi Rushiti.



Në kuadër të ristrukturimit dhe funksionimit të Qendrës së Kulturës, Medias, Botimeve të Mbrojtjes dhe Muzeut të Forcave të Armatosura, si dhe impaktit të saj në jetën social-kulturore të FA-së, duke ju referuar prioritetit shtetëror, i cili ka të bëjë me festimet e 110 vjetorit të krijimit të shtetit Shqiptar, dhe përvjetorin e themelimit të Ushtrisë Shqiptare, kërkohet bashkëpunimi i strukturave të Forcave të Armatosura, me qëllim evidentimin, përzgjedhjen dhe rekrutimin e ushtarakëve të aftë, e me dhunti për të marrë pjesë në korin e FA-së që po ngrihet. Ky formacion artistik do të jetë një nga shtyllat kryesore të festimeve të 110 vjetorit të krijimit të shtetit Shqiptar, krahas Orkestrës Simfonike e sapo krijuar, si dhe Orkestrës Frymore të Forcave të Armatosura.

NJOFTIM!

Në kuadër të **ristrukturimit** dhe funksionimit të **Qendrës së Kulturës**, Medias, Botimeve të Mbrojtjes dhe Muzeut të Forcave të Armatosura, si dhe impaktit të saj në jetën social-kulturore të FA-së, duke ju referuar prioritetit shtetëror, i cili ka të bëjë me festimet e **110 vjetorit** të krijimit të shtetit **Shqiptar**, dhe përvjetorin e themelimit të **Ushtrisë** Shqiptare, kërkohet bashkëpunimi i strukturave të **Forcave të Armatosura**, me qëllim evidentimin, përzgjedhjen dhe rekrutimin e ushtarakëve të aftë, e me dhunti për të marrë pjesë në korin e FA-së që po ngrihet.

Ky formacion artistik do të jetë një nga shtyllat kryesore të festimeve të 110 vjetorit të krijimit të shtetit Shqiptar, krahas **Orkestrës Simfonike** e sapo krijuar, si dhe Orkestrës Frymore të Forcave të Armatosura.